



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 357 Akti

Nr. 468 Vendimi
Tiranë, më 1.11.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)
Roland Ilia
Brunilda Bekteshi

Kryesuese
Relator
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. **Marie Tuma**, në datën 28.10.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Znj. Arbena Ahmeti, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Arbena Ahmeti, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në nëntor të vitit 2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Brunilda Bekteshi.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues, komisionere Genta Tafa (Bungo), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arbena Ahmeti.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Arbena Ahmeti, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua akti i kontrollit me nr. *** prot., datë 10.1.2018, e ILDKPKI-së, protokolluar pranë KPK nr.*** datë 4.9.2018, ku është kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit Arbena Ahmeti, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative Tiranë.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendim nr.***, datë 12.7.2021, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënat arkivore të KLGJ-së. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 26.10.2020, për subjektin e rivlerësimit, është protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.10.2020.

11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë së figurës dhe vlerësimin profesional, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arbena Ahmeti; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës, subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 12.10.2021 mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti pasi u njoh me aktet e dosjes, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja.

14. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 26.10.2021, vendosi të ftojë subjektin Arbena Ahmeti në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti, u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 26.10. 2021.

16. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 28.10.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Arbena Ahmeti ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) “Deklarata e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) dosjen e administruar për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit (i cili është subjekt i rivlerësimit kalimtar) sipas vendimit të trupës.
- e) përgjigjet e pyetjeve drejtuar subjektit dhe bashkëshortit gjatë komunikimit në kuadër të procesit të rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016;
- f) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;

¹ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

g) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

ILDKPKI-ja me aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Arbena Ahmeti, ka konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2006, me numër indeksi *** dhe ka dorëzuar deklaratat e interesave private, ndër vite, për periudhën 2006 – 2016 dhe deklaratën *Vetting*.

Hetimi i kryer nga Komisionit, është përqendruar në: (i) vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaratën *Vetting* të datës 26.1.2017; (ii) dosjen e bashkëshortit të subjektit duke përfshirë dhe pyetsorit; si dhe (iii) verifikimin e informacioneve të marra në rrugë ligjore gjatë hetimit administrativ, me qëllim evidentimin e rasteve të fshehjes së pasurive, deklarimeve të rreme, të ardhurave të paligjshme, si dhe rastet e konfliktit të interesave.

Pjesa më e madhe e të dhënave dhe provave shkresore, lidhur me pasurinë dhe me pyetësorët për këtë subjekt, janë marrë dhe administruar nga dosja e bashkëshortit të subjektit A.Ç, sipas vendimit të trupit gjykues. Kjo nisur nga fakti se pasuritë e subjektit janë të njëjta pasuri me të bashkëshortit dhe se procedura për bashkëshortin e subjektit (si subjekt rivlerësimi) ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 23.3.2021, të Komisionit.

Lidhur me këtë i është kërkuar subjektit nëse mban të njëjtin qëndrim të përgjigjeve të pyetësorëve të dërguar nga bashkëshorti gjatë procesit të rivlerësimit të tij.

Në përgjigje të pyetësorit² subjekti ka deklaruar se i përmbahet përgjigjeve të dhëna nga bashkëshorti i saj gjatë procesit të rivlerësimit.

Në deklaratën *Vetting* të dorëzuar në ILDKPKI, në datën 26.1.2017, subjekti dhe personat e lidhur, kanë deklaruar pasuritë si vijojnë:

1. Apartament me sipërfaqe 76 m² (67 m² sip. banimi +9 m² sip. në bashkëpronësi), me adresë: rruga “****”, kompleksi “****”, godina ***, shk. ***, k. ***, Njësia Administrative Nr. ***, ndërtesa nr. ***, Tiranë, me vlerë 60,800 euro, në pjesë takuese 50%. Blerë sipas kontratës së porosisë me nr. *** prot., datë 9.9.2008. Dorëzimi i apartamentit në vitin 2010. Aktualisht apartamenti nuk është i regjistruar në regjistrat publikë të administruar nga ZVRPP-ja Tiranë.

Burimi i deklaruar i krijimit: (a) të ardhura nga paga si magjistrate, gjyqtare dhe juriste pranë Bashkisë Tiranë; (b) të ardhura nga paga e bashkëshortit si prokuror dhe si magjistrat; (c) kontratë huamarrje (verbale) në vlerën 10,000 euro me nënën, znj. N.T; (ç) kontratë huamarrje (verbale) në vlerën 5,000 euro me vjehrrin I.Ç; si dhe (d) kontratë kredie bankare me “Alpha Bank”, në vlerën prej 3,000,000 lekësh.

²Shihni përgjigjen e pyetsorit nr. 2 të dërguar nga subjekti.

Hetimi i Komisionit

1.1 Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor, datë 8.11.2017, pasuria nr. ***, është regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortit në ZVRPP-në Tiranë. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit³ bashkëshorti i subjektit ka vënë në dispozicion vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 8.11.2017, sipas të cilit pasuria është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me numër ***, pas plotësimit të deklaratës Vetting të vitit 2017.

1.2 OSHEE-ja⁴ konfirmoi kontratën nr.***, me kod klienti ***, që i përket abonentit A.Ç (bashkëshorti i subjektit), e cila është hapur në datën 27.3.2010.

1.3 Gjatë hetimit rezultoi se me kontratën e shitjes nr. ***, datë 7.8.2017⁵, është blerë apartamenti me numër pasurie ***, me sip. 67 m², nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas të cilës, çmimi i shitjes prej 60,800 euro, është likuiduar sipas kontratës së porosisë.

1.4 Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti dhe bashkëshorti, ndër vite, si vijon:

- Në DPV-në e vitit 2008 deklarohet kontratë porosie nr. *** prot., datë 9.9.2008, lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit me sip. 76 m², në vlerën 60,800 euro. Pjesa takuese: 50%. Nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie në DPV-në e vitit 2008. Në rubrikën “detyrime financiare”, janë deklaruar dy hua të marra nga shtetasit N.T dhe I.Ç (nëna e subjektit dhe babai i bashkëshortit të subjektit), përkatësisht, në shumat 10,000 euro dhe 5,000 euro, të cilat kanë shërbyer si burim për pagimin e kështit të parë, në vlerën 18,000 euro.

- Në DPV-të për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014 apartamenti deklarohet në proces regjistrimi në ZVRPP-në Tiranë.

1.5 Lidhur me mënyrën e krijimit të pasurisë dhe likuidimin e çmimit të blerjes, nga aktet e administruar në dosje, rezultoi se:

➤ Me kontratë porosie me vërtetim nënshkrimi nr. *** prot., datë 9.9.2008⁶, shtetasit Arbena Ahmeti dhe bashkëshorti A.Ç, kanë porositur pranë shoqërisë “****” sh.p.k., apartament me sipërfaqe në total 76 m², kati i ***, shk. ***, godina ***, rruga “****”, Tiranë, kontratë sipas të cilës, çmimi i shitjes së sendit të ardhshëm do të jetë në vlerën 60,800 euro dhe do të paguhet nga blerësi, si vijon:

- kështin e parë në vlerën 18,000 euro me nënshkrimin e kontratës;
- kështin e dytë në vlerën 19,000 euro brenda datës 15.12.2008;
- kështin e tretë në vlerën 20,000 euro brenda datës 5.3.2009;
- kështin e katërt dhe të fundit në vlerën 3,800 euro, me marrjen në dorëzim të apartamentit dhe nënshkrimin e autorizimit të dorëzimit të çelësave brenda datës 30.6.2009; si dhe
- pagesat që do të kryhen nga blerësi do të vërtetohen me faturat e transfertave bankare.

1.6 Pasi është pyetur bashkëshorti i subjektit, në lidhje me mënyrën e pagesave të kësteve për likuidimin e çmimit të shitjes, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, ka deklaruar se: “Unë dhe bashkëshortja kemi zbatuar kontratën me shoqërinë ndërtuese, pagesat janë bërë sipas përcaktimeve në nenin 3 të kontratës; (1) kështi i parë prej 18,000 (tetëmbëdhjetëmijë) euro është paguar në datë 9.9.2008 nëpërmjet bankës së nivelit të dytë, në të njëjtën datë të nënshkrimit të kontratës së porosisë me nr. *** prot., datë 9.9.2008, në zbatim të pikës 3.2, të nenit 3, të kontratës; (2) kështi i dytë prej 19,000 (nëntëmbëdhjetëmijë) euro është paguar në datën 12.12.2008, nëpërmjet bankës së nivelit të dytë, në zbatim të pikës 3.3, të nenit 3, të kontratës, që parashikonte si afat të fundit për pagesën e kështit të dytë, në datën 15.12.2008; (3) kështi i tretë prej 20,000 (njëzetmijë)

³Shihni përgjigjen e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në dosjen e administruar nga Komisioni.

⁴Shihni shkresën kthim përgjigje të OSHEE-së në praktikën e bashkëshortit të subjektit.

⁵Shihni dokumentin bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. *** në dosjen e Komisionit.

⁶Shihni aktin në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së për bashkëshortin e subjektit.

euro është paguar në datën 10.3.2009 nëpërmjet bankës së nivelit të dytë, 'Alpha Bank' (banka ku kemi marrë kredinë), në zbatim të pikës 3.4, të nenit 3, të kontratës, që parashikonte si afat të fundit për pagesën e kështit të dytë, datën 15.3.2009; (4) kësti i katërt dhe i fundit është paguar në shumën prej 3,643 euro me mandatarkëtimin nr. ***, datë 24.4.2010, pranë shoqërisë ndërtimore”.

1.7 Pas verifikimeve, rezultoi se pretendimet e subjektit janë të bazuara në dokumentet bankare si vijojnë:

a) njoftim kreditimi të Bankës Amerikane të Shqipërisë, datë 9.9.2008, në të cilin konfirmohet se shtetasit A.Ç dhe Arbena Ahmeti, i kanë kryer parapagimin shoqërisë “****” sh.p.k., për blerje banese në shumën 18,000 euro;

b) njoftim kreditimi të Bankës Amerikane të Shqipërisë, datë 12.12.2008, në të cilin konfirmohet se shtetasit Arbena Ahmeti dhe A.Ç, i kanë kryer pagesën e kështit të dytë për blerje banese shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 19,000 euro;

c) transfertë, datë 10.3.2009, nga shtetasi A.Ç, te shoqëria “****” sh.p.k., të shumës 20,000 euro, për blerje apartamenti. Në datën 10. 3.2009, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga llogaria e tij në lekë në “Alpha Bank”⁷, shumën 2,550,000 lekë. Në të njëjtën datë shtetasi A.Ç ka derdhur në llogarinë e tij në euro, shumën prej 20,030 euro dhe nga kjo shumë 20,000 euro i kanë kaluar shoqërisë;

ç) mandatarkëtimin nr. ***, datë 24.4.2010, në shumën 3,643 euro, që shtetasit A.Ç dhe A.A kanë derdhur për shoqërinë “****”,.

Kësti i fundit duket se nuk i ka kaluar shoqërisë “****” sh.p.k. Në lidhje me këtë fakt, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se : “ kontrata e porosisë është negociuar dhe nënshkruar në selinë e grupit ‘***, pjesë e të cilit është shoqëria tregtare ‘***’ sh.p.k., me të njëjtin përfaqësues ligjor (administrator) z. A.D. Në të njëjtën zyrë është bërë pagimi i kështit të fundit, po ashtu dhe kontrata e kalimit të pronësisë së apartamentit me shoqërinë tregtare ‘***’.... ”. Për të vërtetuar pretendimin e tij, bashkëshorti i subjektit ka vënë në dispozicion printime nga faqja e zyrtare e shoqërisë “****”, ku pasqyrohen kompanitë që përfshihen në këtë grup, ndër të cilat edhe kompania “****” sh.p.k.

1.8 Pavarësisht se administratori mund të jetë i njëjti për dyja shoqëritë, Komisioni konstatoi se subjekti dhe bashkëshorti kështin e fundit të pretenduar ia kanë kaluar një shoqërie tjetër, e cila është subjekt juridik më vete dhe jo shoqërisë me të cilën është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë apartament.

Në total duket se është paguar shuma 60,643 euro, nga shuma prej 60,800 e përcaktuar në kontratën e porosisë dhe shitjes.

1.9 DPPPP-ja⁸ ka informuar raportimin e transaksioneve të sipërpërmendura (por jo vetëm), si vijon:

- në datën 9.12.2008, subjektit Arbena Ahmetaj, ka prenotuar apartament për çmimin e deklaruar në vlerën 60,800 euro, te shoqëria “****” sh.p.k.;

- në datën 25.1.2017, është deklaruar detyrimi i shumës 10,000 euro të marrë hua që në vitin 2008 nga pala huadhënëse, shtetasja N.T për A.Ç.

- në datën 10.3.2009, është deklaruar tërheqje *cash* nga llogaria në “Alpha Bank”, në shumën 2,550,000 lekë;

- në datën 10.3.2009, është deklaruar depozitim në llogari në “Alpha Bank”, në shumën 20,030 euro.

1.10 Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, gjatë hetimit administrativ, janë marrë në shqyrtim burimet e deklaruara nga subjekti dhe bashkëshorti.

⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2018, nga “Alpha Bank”.

⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.3.2019, nga DPPPP-ja në dosjen e Komisionit.

Në lidhje me të ardhurat nga pagat

Në deklaratën *Vetting* nuk janë përcaktuar nga subjekti se sa kanë qenë të ardhurat nga paga që i janë paguar palës shitëse shoqërisë “****” sh.p.k. Subjekti ka pasur detyrimin ligjor të deklarojë saktë burimet e krijimit të pasurisë dhe vlerat përkatëse në deklaratën *Vetting*.

Duke qenë se subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008 se i ka paguar shoqërisë “****” sh.p.k., shumën 7,000 euro (por as në këtë deklaratë periodike nuk deklarohet burimi), si pagesë e këstit të parë dhe të dytë, duket se 10,000 +5,000 euro ishin nga huat dhe 22,000 euro duket se janë përballuar nga të ardhurat nga paga.

Në lidhje me kontratën e huamarrjes (verbale) në vlerën 10.000 euro, me nënën e subjektit, znj. N.T

Në lidhje me këtë hua, nga aktet e administruara u konstatua se:

- Nuk rezultoi dokument shkresor i vitit 2008 që të vërtetojë dhënien e huas këtë vit. Me deklaratën noteriale⁹ nr. ***, datë 25.1.2017, shtetasja N.T deklaroi se në vitin 2008, i ka dhënë hua shumën 10,000 euro, pa afat dhe pa interes, vajzës Arbena Ahmeti, për ta ndihmuar për blerjen e banesës me bashkëshortin A.Ç dhe se kjo shumë i është kthyer totalisht.

- Kjo hua është deklaruar në DPV-në e vitit 2008 dhe deri në DPV-në e vitit 2013, kur është deklaruar shuarja e detyrimit financiar.

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, bashkëshorti i subjekti ka deklaruar se: “*Shuma prej 10.000 (dhjetëmijë) euro është marrë dorazi, sipas marrëveshjes verbale midis nesh, pa një kontratë të shkruar në formë, për shkak të marrëdhënies, të posaçme familjare... ”.*

1.11 Nga verifikimi i DPV-në dhe dokumenteve bankare të përmendura në këto deklarata, u konstatua se shlyerja e huas është bërë me këste, sipas deklarimeve të subjektit, në këtë mënyrë : (1) kësti në vlerën 5,000 euro është shlyer *cash* në vitin 2009, deklaruar në DPV-në për vitin 2009; (2) kësti në vlerën 3,000 euro, është shlyer nëpërmjet “Tirana Bank”, sipas depozitës në arkë në datën 30.12.2011, deklaruar në DPV-në për vitin 2011; (3) kësti në vlerën 2,000 euro, është shlyer nëpërmjet “Tirana Bank”, sipas depozitës në arkë në datën 22.01.2013, deklaruar në DPV-në për vitin 2013.

Në vitin 2013, është deklaruar shlyerja totale e huas.

1.12 Lidhur me mundësitë financiare, për të kthyer huat në vitet 2009, 2011 dhe 2013, referojuni analizës financiare në vijim të vendimit.

1.13 Në lidhje me ligjshmërinë e burimeve financiare për dhënien e huas nga znj. N.T, në cilësinë e personit të lidhur, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, bashkëshorti i subjektit ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumente shkresore, për mundësinë e saj, si vijon:

- deklaruar shuma 1,900,000 lekë e përfituar nga shitja pasurive së paluajtshme me kontratën noteriale nr. ***, datë 29.8.2006. Sipas kësaj kontrate rezultoi se: (i) znj. N.A(T), nëna e subjektit, ka qenë pronare e pasurisë nr. ***, apartament me sip. 20 m², Lushnjë; dhe (ii) së bashku me ish-bashkëshortin, A.A, kanë qenë bashkëpronarë të pasurisë nr. ***, apartament me sip 54 m², Lushnjë. Këto pasuri i shitën përkatësisht në përkatësisht në vlerat 400,000 lekë dhe 1,500,000 lekë, në total 1,900,000 lekë. Për këtë rezultoi dhe pagesa e tatimit mbi shitjen pranë ZVRPP-së Lushnjë, në shumën 9,500 lekë, paguar sipas dy mandatarkëtimeve: nr. ***, datë 30.8.2006 dhe nr. ***, datë 30.8.2006.

1.14 Referuar kontratës së shitjes, pjesa takuese e znj. N.T, ka qenë 400,000 lekë nga shitja e pasurisë *** dhe 750,000 lekë (1/2 e shumës 1,500,000 lekë), nga shitja e pasurisë nr. ***, në total

⁹Shihni aktin në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së për bashkëshortin e subjektit.

në vlerën 1,150,000 lekë. Duke zbritur tatimin e paguar mbi shitjen, në shumën 9,500 lekë, totali i të ardhurave të znj. N.T është në shumën 1,140,500 lekë.

1.15 Në përgjigjet e pyetësorit të datës 11.2.2020, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. N.T, edhe pas zgjidhjes së martesës ligjore me shtetasin A.A ka vijuar bashkëjetesën me të, duke u shprehur se: “... znj. N.T kishte zgjidhur martesën ligjore me z. A.A në vitin 1994 dhe sipas vendimit të gjykatës i ishin lënë në kujdestari tre fëmijët dhe banesa bashkëshortore me nr. pasurie ***”. Më tej, ai sqaron se: “ Që prej vitit 1999 e në vijim ata kanë bashkëjetuar në të njëjtin apartament deri në vitin 2001, vit në të cilin si familje janë vendosur në Tiranë, në apartamentin e blerë nga babai i bashkëshortes me të ardhurat nga emigracioni, në rrugën ‘***’. Në këtë banesë ka jetuar edhe nëna e bashkëshortes deri në vitin 2016, e në këto kushte të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës në qytetin e Lushnjës, në shumën prej 1,900,000 lek, janë administruar prej saj. Në vitet 2006, 2007 dhe 2008 ajo ka qenë në certifikatë familjare si kryefamiljare së bashku me tre fëmijët e saj (Arbena Ahmeti është shkëputur nga trangu në vitin 2007)...”.

1.16 Për këtë çështje është pyetur nga Komisioni në cilësinë e dëshmitarit babai i subjektit, z. A.A, i cili në deklaratimet e tij pohoi¹⁰ se pas zgjidhjes së martesës ka bashkëjetuar me znj. N.T dhe se të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së përbashkët në Lushnjë, si dhe të ardhurat e tij nga emigracioni i ka administruar gjithmonë ish-bashkëshortja. Ndërkohë, deklaroi se nuk disponon dokumente për të vërtetuar të ardhura nga emigracioni, për shkak se kanë qenë vite të hershme.

1.17 Nga Komisioni, u morën nga DPGJC adresat e regjistrimit në gjendje civile të shtetasve N.T dhe A.A, nga ku rezultoi se në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, të dy këta shtetas figurojnë të regjistruar banorë në të njëjtën adresë, në të njëjtin pallat dhe në të njëjtën shkallë¹¹, rruga “***”, pallati nr. ***, shkalla nr. ***, apartamenti nr.***, Tiranë. Pra, shtetasit A.A dhe N.T, figurojnë të regjistruar në të njëjtën adresë të gjendjes civile, e cila përkon me adresën e pasurisë nr. ***, z. k. ***, Tiranë, në pronësi të shtetasit A.A.

1.18 Subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e pasurisë tokë truall në qendër të qytetit të Lushnjës, pasuri në bashkëpronësi, si trashëgimtare e radhës së parë, 1/12 pjesë takuese, sipas kontratës nr. ***, datë 7.11.2006, me çmim të shitjes 1,000,000 lekë. Është pretenduar se realisht znj. N.T, ka përfitur nga shitja shumën 4,631 euro, por nuk e vërteton këtë pretendim me dokumente shkresore. Nga shitja e kësaj pasurie, vërtetohet e ardhura në shumën 83,000 lekë, e cila u përfshi në analizën financiare.

1.19 Subjekti ka deklaruar të ardhura të shtetasit D.A (djali i znj. N.T), si i vetëpunësuar, po pa u dokumentuar pagimi i sigurimeve shoqërore dhe detyrimeve tatimore, si dhe të ardhura nga znj. D.A (vajza e znj. N.T), në shumën 294,147 lekë, për periudhën 2007 – 2008, shumë e cila u përfshi në analizën financiare.

1.20 Për të verifikuar mundësinë e personit të lidhur/N.T, për dhënien e huas në shumën 10,000 euro, në vitin 2008, Komisioni ka kryer analizë financiare, për periudhën 1994 – 2008, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese, ku shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas përbërjes familjare.

1.21 Subjekti në përgjigje të pyetësorit¹² ka deklaruar dhurimin e shumës 300,000 lekë nga nëna e saj, me burim të ardhurat nga shitja e pasurisë apartament blerësit K.N, në vitin 2006. Ky dhurim është përfshirë në analizën e mundësisë financiare të huadhënies nga nëna e subjektit, në vlerën 10,000 euro.

¹⁰Shihni procesverbalin e pyetjes së shtetasit A.A në dosjen e Komisionit për bashkëshortin e subjektit.

¹¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.6.2020, nga DPGjC-ja, në dosjen e Komisionit.

¹²Shihni përgjigjet e subjektit në pyetësorin nr. ***, pikat 4 dhe 5.

Analiza e mundësisë së huadhënies në shumën 10,000 euro, nga znj. Nurisha Topulli, në vitin 2008

Përshkrimi	Periodha 1.9.2006 – 31.12. 2008
Të ardhura nga shitja e apartamentit më 29.8.2006	1,900,000
Të ardhura nga shitja e truallit në Lushnjë më 27.11.2006	83,333
Të ardhura nga puna D.A	294,147
Të ardhura totale	2,277,480
Shpenzime jetese 4 persona	1,239,036
Dhënë subjektit 300,000 lekë, në vitin 2006	300,000
Dhënë subjektit 10,000, në vitit 2008	1,231,825
Shpenzime totale	2,770,861
Pamundësia financiare	-493,381

Bazuar në analizën financiare rezultoi pamundësi e huadhënese N.T për dhënien e huas në shumën 10,000 euro, në vitin 2008, të ardhura që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë apartament në bashkëpronësi me bashkëshortin.

1.22 Shlyerja e kësaj huaje është deklaruar nga subjekti dhe bashkëshorti në DPV-të për vitet 2009, 2011 dhe 2013. Bazuar në analizën financiare të vitit 2009 dhe 2011, rezultoi që subjekti ka pasur mundësi për shlyerjen përkatësisht të vlerave 5,000 euro dhe 3,000 euro.

1.23 Lidhur me mundësinë e pagesës së vlerës 2,000 euro në datën 18.1.2013 është bërë analiza financiare ku rezultoi se subjekti ka pasur pamundësi financiare në vlerën prej 303,228 lekë.

1.24 Në bazë të analizës financiare, subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi financiare për shlyerjen e këstit 2,000 euro nënës së saj, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera.

1.25 Në përfundim Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit lidhur me:

- Komisioni mori në konsideratë të ardhurat nga huadhënia në shumën 1,900,000 lekë, por rezultoi se personi tjetër i lidhur/N.T nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të dhënë subjektit të rivlerësimit huan në shumën 10,000 euro, në vitin 2008.
- Personi tjetër i lidhur ka qenë në pamundësi financiare në vlerën 493,381 lekë, për huadhënien e pretenduar në shumën 10,000 euro.
- Për këtë arsye, huaja në shumën 10,000 euro nuk është përfshirë në analizën financiare të hartuar nga Komisioni në vitin 2008.
- Subjekti ka qenë në pamundësi financiare për shlyerjen e këstit të huas në vlerën 2,000 euro, në datën 18.1.2013.

1.26 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: *“Nëna ime, znj. N.T, ashtu siç kemi sqaruar më parë, ka përfiturar në tërësi të ardhura nga shitja e banesës së prindërve të mi në Lushnjë. Ky është burimi i ligjshëm i shumës së dhënë në hua, bashkëshortit dhe mua. Nëna më ka dhënë shumën 10,000 euro, në hua, pasi e kishte të disponueshme këtë shumë kur ia kemi kërkuar. Ndërsa jetesa e nënës sime dhe familjes është mbuluar, në këtë periudhë kohore, me të ardhurat nga paga e anëtarëve të familjarëve, punës së saj, disponimet në shumat monetare që kanë pasur si rezultat i llogarive bankare që datojnë që prej vitit 2001, si dhe shitja e pasurive të paluajtshme, që ka përfiturar si bashkëtrashëgimtare ligjore e ish-pronarëve.*

Kështu, është shitur një truall në bashkëpronësitë trashëgimtarëve të familjes së nënës sime N.T. Këto shuma, pavarësisht se formalisht kontrata e shitjes nuk ka pasqyruar, jo për faj të nënës sime, çmimin e referencës së shitjes së truallit konkret, ato faktikisht kanë qenë të disponueshme dhe në masë të tillë që t'i krijojnë familjes sime mundësinë për të përballuar shpenzimet e jetesës së tyre.

Në lidhje me llogaritjen e shpenzimeve të jetesës së familjes sime të origjinës në këtë periudhë kohore, sqarohet se familja ka disponuar të dokumentuar në llogari bankare shuma monetare që përfaqësonin kursimet familjare, nga emigracioni i babait, puna dhe përfitime nga pasuritë e paluajtshme.

Gjithashtu, nëna ime si personi që administronte ekonominë familjare ka pasur llogari bankare në emrin e saj. Bashkëlidhur, iu lutem gjeni dokumente bankare në emër të nënës N.T (Ahmeti).

*Dua të sjell në vëmendje të trupit gjykues se nëna N.T, është trashëgimtare e familjes më të madhe pronare të tokave në qytetin e Lushnjës, familja T, prona këto që na janë njohur dhe kthyer në një pjesë të tyre dhe mbi këto troje sot janë të ndërtuar pothuajse të gjithë pallatet e reja në rrugën '***', në Lushnjë. Një pjesë e këtyre pronave janë shitur sipas kontratave që kemi depozituar gjatë procesit të rivlerësimit.*

Këto shuma monetare, si dhe shumatat monetare të disponuara në bankë që prej vitit 2000-2001, kanë shërbyer familjes time për të përballuar jetesën. Pavarësisht pamundësisë sime aktuale për të provuar me dokumentacion burimin e tyre, por mbi bazën e dokumentacionit shkresor të depozituar arrij të provojë disponibilitetin e tyre, ato nuk mund të përjashtohen si burime financiare të familjes për të përballuar jetesën, për sa kohë, që është dokumentuar disponimi i tyre dhe nuk rezulton të jenë përdorur në shpenzimet apo investime për krijimin e pasurive të tjera, por vetëm për shpenzime të familjes.

Si më lart shpjegova, i kërkoj trupit gjykues, që të mbajë në vlerësim se brenda objektit të përcaktuar në ligj, kam shteruar detyrimin kushtetues për barrën e provës, në lidhje me shumën monetare respektive, të dhënë në hua, prej 10,000 euro, të cilën bashkëshorti dhe unë ia kemi shlyer familjes time, në kohë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, të deklaruar saktë si veprime, në çdo DVP. Përkundër kësaj unë si subjekt deklaroj pranë ILDKPKI-së kam qenë korrekte dhe kam ruajtur dhe ju kam vënë në dispozicion gjatë hetimit administrativ, çdo dokumentacion, që lidhet me mua dhe persona të lidhur me mua, për çdo të ardhur të krijuar, në mënyrë të ligjshme, pavarësisht kohës së gjatë të deklarimit periodik të pasurisë, mbi 15 vjet.

Në tërësi të rrethanave të shqyrtuara prej trupit gjykues, në raport me shpjegimet e paraqitura dhe provat që i mbështesin, arrihet të krijohet bindja e plotë se, është i saktë deklarimi dhe kërkoj që të përfshihet në analizën financiare shuma 10,000 euro, në vitin 2008.

Në lidhje me konstatimin se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për shlyerjen e këstit në shumën 2,000 euro, në datën 18.1.2013, për shkak të detyrimit të marrëdhënies së huas me nënën time, si shlyerje e pjesshme, sqarohet se:

- Referuar përmbajtjes së DVP-së së vitit 2012, gjendja e pasurisë, në formën e cash që është mbartur në datën 1.1.2013, e deklaruar në këtë DVP ka qenë në vlerën 300,000 lekë. Pra, aftësia financiare për të paguar këtë detyrim ka qenë plotësisht e mundshme dhe pa llogaritur të ardhurat e përfituara prej pagës time dhe të bashkëshortit, për muajin janar.
- Sipas ligjit të zbatueshëm në kohë, në DVP-në e vitit 2013 (shihni faqen *** të formularit të DVP-së së vitit 2013), në rubrikën përkatëse nuk ka qenë detyrim të deklarohet burimi i të ardhurave për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve. Referuar këtij ligji duhet të deklarohet burimi për krijimin e pasurive dhe jo burimi për shlyerjen e detyrimeve”.

1.27 Pas shpjegimeve të sjella nga subjekti, lidhur me mundësinë financiare për shlyerjen e huas në vlerën 2,000 euro në datën 18.1.2013, Komisioni mori parasysh edhe gjendjen cash të deklaruar

nga subjekti në DPV-në e vitit 2012. Në përfundim, Komisioni hartoi një analizën financiare si vijon:

Analiza e mundësisë së derdhjes së shumës 2,000 euro te llogaria e nënës së subjektit, në datën 18.1.2013

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga Arbena Ahmeti (subjekti) 1.1.2013 – 18.1.2013	66,097
Të ardhura nga paga A.Ç (bashkëshorti) 1.1.2013 – 18.1.2013	78,785
Të ardhura totale 1.1.2013 – 18.1.2013	144,882
Depozituar 2,000 euro në llogari te N. T., më 18.1.2013	280,420
Shpenzime jetese 1.1.2013 – 18.1.2013	16,159
Shpenzime udhëtimi 1.1.2013 – 18.1.2013	56,084
Shpenzime transport i brendshëm 1.1.2013 –18.1.2013	2,500
Shpenzime totale	355,163
Ndryshim likuiditeti 1.1.2013 – 18.1.2013	-208,522
Pamundësi kursimi	-1,759

Bazuar në këtë analizë, rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kanë pamundësi financiare për shlyerjen e kësaj huaje dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera në vlerën 1,759, që për Komisionin nuk konsiderohet penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

Në lidhje me kontratë huamarrje verbale për shumën 5,000 euro, marrë nga babai i bashkëshortit të subjektit, z. I.Ç

✓ Në lidhje me këtë burim, nga aktet në dosje rezulton se:

Nuk ka një akt shkresor të vitit 2008 që të vërtetojë dhënien e huas. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 23.1.2017¹³, shtetasi I.C deklaroi se në vitin 2008, i ka dhënë hua shumën 5,000 euro, pa afat dhe pa interes, djalit A.Ç, për blerjen e banesës bashkëshortore së bashku me shtetasen Arbena Ahmeti. Kjo shumë i është kthyer totalisht.

Marrëdhënia e huas nuk është formalizuar me akt shkresor në kohë reale. Në DPV-në për vitin 2008, periudhë kur është marrë huaja dhe deri në vitin 2012 kur është deklaruar shuarja e detyrimit financiar, subjekti ka deklaruar në lidhje me huan verbale marrë z. I.C, si dhe detyrimin financiar të mbetur. Bashkëshorti i subjektit deklaroi se: “... *shuma prej 5,000 euro është marrë dorazi, sipas marrëveshjes verbale midis nesh, pa një kontratë të shkruar në formë, për shkak të marrëdhënies, të posaçme familjare*”.

Në lidhje me ligjshmërinë e burimeve financiare për dhënien e huas nga z. I.C, në cilësinë e personit të lidhur, është pyetur bashkëshorti i subjektit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. ***, ka deklaruar se: “*Prindërit e mi, zj. P.Ç dhe z. I.Ç, në periudhë kohore të dhënies së huas në shumën 5,000 (pesëmijë) euro kanë realizuar të ardhura prej pagës së tyre si mjekë, në qytetin e Lushnjës*”.

Për të vërtetuar këtë pretendim ka paraqitur dhe dokumentet shkresore si vijojnë:

- vërtetim nr. *** prot., datë 31.8.2018, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Qendra Shëndetësore Lushnjë;
- vërtetim nr. *** prot., datë 13.8.2018, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë;
- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* nga Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Lushnjë;

¹³Shihni aktin në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nga Qendra Shëndetësore Nr. *** Lushnjë;

- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nga DRFSDKSH-ja;

- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nga Drejtoria Kujdesit Shëndetësor.

Bashkëshorti i subjektit pretendoi se përveç të ardhurave nga paga, nëna e tij P.Ç, ka pasur depozitë në shumën 500,000 lekë, në emër të saj dhe nënës së saj, L.P, në “Raiffeisen Bank”, duke sqaruar se: “... kjo llogari ka qenë në emër të gjyshes time, të ndjerës, L.P, dhe nëna ime ka qenë përfituesja pas vdekjes së gjyshes në datë 19.4.2005, sipas parashikimit të kontratës me bankën”.

Pasi janë verifikuar informacionet nga bankat e institucione të tjera, në lidhje me pasuri të personit të lidhur I.Ç, nga Komisioni është kryer analizë financiare me të dhënat që disponohen, përmbledhur sipas tabelës vijuese, duke llogaritur shpenzimet e jetesës familjare, sipas standardit të ILDKPKI-së. Shpenzimet e jetesës përfshijnë edhe fëmijët A dhe A.Ç, deri në momentin kur ato sigurojnë të ardhurat e veta përkatësisht në tetor 2006 dhe tetor 2008.

Analiza financiare lidhur me mundësitë e z. I.Ç për huadhënie të vlerës 5,000 euro

Përshkrimi	Periudha 1994 - 2008
Të ardhura nga paga I dhe P.Ç	7,352,196
Depozitë P. Ç tërhequr në vitin 2005	500,000
Të ardhura nga kredia në “Alpha Bank” në vitin 2007	1,209,100
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Lushnjë në vitin 1999	1,000,000
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Lushnjë më 13.11.2006	1,800,000
Total të ardhura	11,861,296
Shpenzime jetese	4,501,740
Blerë pasuri në Lushnjë në vitin 1996	1,150,000
Blerë pasuri në tetor 2008 në Lushnjë	4,143,480
Blerë pasuri në shtator 2008 në Lushnjë	3,200,000
Dhënë 500,000 lekë A.Ç për blerje automjeti në vitin 2006	500,000
Dhënë 5,000 euro A.Ç në vitin 2008	615,913
Shlyerje kredie në “Alpha Bank”	366,821
Total shpenzime	14,477,954
Pamundësia financiare për dhënie e shumës 5,000 euro	-2,616,658

Analiza e mësipërme fillon në vitin 1994 dhe mbaron në vitin 2008, vit kur është dhënë huaja në vlerën prej 5,000 euro. Siç vërehet nga kjo analizë, të ardhurat në vlerën 11,861,296 lekë nuk kanë mjaftuar për të krijuar pasuritë dhe për dhurimet e huadhëniet gjatë këtyre viteve, për shkak të pamundësisë financiare në vlerën 2,616,658 lekë.

Shlyerja e kësaj huaje është deklaruar nga subjekti dhe bashkëshorti në DPV-në e vitit 2012. Bazuar në analizën financiare të vitit 2012, rezultoi që subjekti ka pasur mundësi për shlyerjen e vlerës 5,000 euro.

1.28 Në përfundim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit lidhur me:

- Rezultoi se personi tjetër i lidhur/I.Ç nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të dhënë shumën e huas në vlerën 5,000 euro në vitin 2008 subjektit të rivlerësimit.
- Personi tjetër i lidhur ka qene në pamundësi financiare në vlerën 2,616,658 lekë për huadhënien e pretenduar prej 5,000 euro.

- Personi tjetër i lidhur ka qenë në pamundësi financiare edhe për blerjen e pasurisë apartament në qytetin e Lushnjës, apartament i cili ka qenë në përdorim nga subjekti dhe bashkëshorti për periudhën 2007 – 2010¹⁴.
- Për këtë arsye, huaja në shumën 5,000 euro nuk është përfshirë në analizën financiare në vitin 2008.

1.29 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se:

“Gjatë hetimit administrativ kemi paraqitur të ardhurat e prindërve të bashkëshortit, ndër vite, pagat e tyre si mjekë në qytetin e Lushnjës, të ardhura nga trashëgimia dhe të tjera, për të provuar aftësinë e tyre për të na dhënë shumën monetare prej 5,000 euro, në hua, me qëllimin që të bënim pagesën e këstit të radhës sipas kontratës së porosisë, për apartamentin tonë.

Në lidhje me konstatimin prej trupit gjykues dhe pasqyrimin në tabelë të të dhënave financiare të prindërve të bashkëshortit, ku është pasqyruar si shpenzim i kryer prej tyre, blerja e dy apartamenteve në qytetin e Lushnjës, në vitin 2008, Ju sqaroj se këto shpenzime janë kryer prej tyre, në vitin 2006 dhe në vitin 2007 dhe jo në vitin 2008, kohë në të cilën na kanë dhënë shumën monetare prej 5,000 euro, në hua.

Sqaroj se këto apartamente janë porositur nga prindërit e bashkëshortit, në muajin mars të vitit 2006, para marrjes së detyrës së prokurorit, të bashkëshortit tim, dhe përpara marrjes së kësaj shume, në hua.

*Në kontratën noteriale të porosisë, lidhur midis babait, z. I.Ç dhe shtetasit A.N, administrator i firmës ndërtuese, datë 10.3.2006, me objekt ‘porosinë për ndërtimin e dy apartamenteve’ është përcaktuar, në përmbajtje të saj dhe mënyra e pagesës së kësteve. Kështu, sipas kontratës së porosisë, janë shlyer pagesat prej prindërve të bashkëshortit dhe në vitin 2007 banesat kanë qenë të përfunduara dhe janë dorëzuar, të dyja, sipas përcaktimeve të kontratës së porosisë. Prej përmbajtjes së dokumenteve shkresorë provohet se, një pjesë e pagesës për blerjen dy apartamenteve rezulton e paguar, para noterit publik, përpara redaktimit të kontratës së porosisë, në zyrën noteriale, datë 10.3.2006, një pjesë është bërë në dorë ndërtuesit, në afatet e përcaktuara në kontratë. Prindërit kanë mundur të gjejnë dhe më kanë vënë në dispozicion mandatpagesë, nr. ***, datë 18.3.2006, për pagimin e shumës prej 35,000 USD.*

*Fakti, që çdo detyrim i prindërve të bashkëshortit ndaj firmës ndërtuese, si shpenzim për blerjen e dy apartamenteve, është përmbushur, brenda mesit të vitit 2007, provohet edhe prej faktit të dorëzimit të tyre për banim, pikërisht në këtë periudhë kohe. Prindërit e bashkëshortit, për të përmbushur detyrimin ndaj firmës ndërtuese, për pagimin e këstit të fundit, për dy apartamentet, në datën 23.4.2007, kanë marrë një kredi bankare, në shumën prej 10,000 euro, pranë bankës së nivelit të dytë ‘Alpha Bank’, me qëllimin e pagimit e një pjese të këstit të fundit. Në datën 12.9.2007, midis prindërve të bashkëshortit dhe KESH është lidhur kontrata me nr. ***.*

Pra, gjatë vitit 2008, prindërit e bashkëshortit, nuk kanë kryer asnjë pagesë për blerje apartamenti, (nuk kanë kryer asnjë shpenzim për këtë qëllim, por kanë përpiluar kontratën e shitblerjes, e cila sipas praktikave të kohës prej noterëve të qytetit të Lushnjës, përpilohej si akt formal. Praktika administrative kërkonte regjistrimin e apartamenteve pranë ASHK-së (ish-ZVRPP), në emër të ndërtuesit, fillimisht dhe më pas bëhej regjistrimi, në emër të palës porositëse.

Kështu që, në lidhje me konstatimin e faktit se, a kishin mundësi financiare, që prindërit, të na jepnin në hua, në fund të vitit 2008 shumën monetare prej 5,000 euro, mua dhe bashkëshortit tim, kërkoj që, prej trupit gjykues të llogariten të ardhurat e tyre, që janë krijuar gjatë vitit 2007-2008, si dhe të llogariten shpenzimet për konsum. Jam i sigurt, që në tërësi të të gjitha fakteve të parashtruara si më lart edhe të provuara mbi bazën e akteve shkresore, që janë vënë në dispozicion, në procesin

¹⁴Shihni më poshtë këtij relacioni komentet lidhur me pasuritë në përdorim.

e rivlerësimi të bashkëshortit, trupi gjykues do krijojë bindjen e plotë, për të arritur në një përfundim të pavarur dhe paanshëm që: në fund të vitit 2008 prindërit e bashkëshortit kanë pasur mundësi financiare, të na jepnin në hua shumën monetare prej 5,000 euro, mua së bashku me bashkëshortin dhe rrjedhimisht, kjo shumë monetare, kërkoj që prej trupit gjykues të përfshihet në analizën financiare”.

1.30 Në lidhje me kontratën e kredisë bankare në “Alpha Bank”, në vlerën 3,000,000 lekë

✓ Në lidhje me këtë burim nga aktet në dosje rezultoi se:

Me kontratë kufi kredie shumëqëllimore nr. ***, datë 22.1.2009, me “Alpha Bank”, vërtetohet akordimi i kredisë në kufirin prej 4,300,000 lekësh, bashkëshortëve Ç, me qëllim blerje apartamenti.

Me vërtetimin e “Alpha Bank”, dega Lushnjë, datë 24.10.2016¹⁵, vërtetohet se më 3.2.2009, shtetasit A.Ç dhe Arbena Ahmeti kanë marrë një kredi për shtëpi në shumën 3,000,000 lekë, e cila është mbyllur më 1.12.2011.

“Alpha Bank” vuri në dispozicion kopjen e kontratës së kredisë të datës 22.1.2009, midis “Alpha Bank” dhe shtetasve A.Ç dhe Arbena Ahmeti, në shumën prej 4,300,000 lekësh¹⁶, nga përmbajtja e të cilës konstatohet se dorëzanës janë prindërit e bashkëshortit të subjektit, shtetasit I.Ç dhe P.Ç, të cilët nëpërmjet kontratës së hipotekës, kanë vënë në hipotekë në favor të bankës dy pasuri: (i) apartament me sip. 66.30 m², në Lushnjë; (ii) apartament me sipërfaqe 96.36 m², Lushnjë.

“Alpha Bank”¹⁷ vërteton kalimin e shumës prej 3,000,000 lekësh, në llogari të shtetasve Arbena Ahmeti dhe A.Ç, në datën 3.2.2009.

Në datën 10.3.2009, është bërë tërheqja nga llogaria në lekë e shumës 2,550,000 lekë dhe, po këtë ditë, pasi kjo shumë duket se është konvertuar në euro, është bërë derdhje e shumës 20,030 euro në llogarinë me numër ***, nga e cila shuma prej 20,000 euro, ka kaluar në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k.

Komisioni ka kërkuar në “Alpha Bank”, praktikën e dhënies së kredisë së dhënë subjektit të rivlerësimit dhe në përgjigjen e saj, ky institucion¹⁸ ka vënë në dispozicion dokumentacion me anën e të cilit vërtetohen faktet si vijojnë:

- Lëvizje të llogarisë bankare ku evidentohet disbursimi i kredisë në shumën 3,000,000 lekë, në datën 3.2.2009. Në këtë datë evidentohen edhe mbajtja e disa shpenzimeve të kredisë në total në shumën 34,632.50 lekë të cilat janë mbajtur nga shuma e disbursuar.

Në datën 3.2.2009 gjendja e llogarisë së kredisë në shumën 2,965,000 lekë është investuar në depozitë me afat 1-mujor, e cila ka gjeneruar një interes në shumën 8,598 lekë.

Me maturimin e depozitës në datën 3.3.2009, shuma prej 2,550,000 lekësh është tërhequr nga subjekti.

✓ Nga deklaratimet periodike, rezultoi se subjekti ka deklaruar në lidhje me marrjen dhe shlyerjen e kredisë me të ardhura të ligjshme, si vijon:

Në DPV-në e vitit 2009 është deklaruar kontratë kredie bankare me “Alpha Bank”, në vlerën 3,000,000 lekë, me afat 13-vjeçar me këste të barabarta mujore, në vlerën 34,100 lekë, solidare nën detyrim me bashkëshortin në masën 50%. Shuma e shlyer 341,000 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur në shumën 2,891,655 lekë.

¹⁵Shihni aktin në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁶Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.8.2019 nga “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit.

¹⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2018, nga “Alpha Bank”.

¹⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.11.2020, nga “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit.

Në DPV-në e vitit 2010 është deklaruar shuma e shlyer prej 866,500 lekësh dhe shuma e mbetur prej 2,316,810 lekësh.

Në deklarinimin për vitin 2011 është deklaruar shlyerja e shumës 2,505,020 lekë, si dhe shlyerja totale e kredisë. Në këtë vit, subjekti deklaroi huan në shumën 1,430,000 lekë marrë nga babai i bashkëshortit I.Ç, me qëllim shlyerjen e kredisë. Lidhur me mundësinë e pagesës së diferencës në shumën prej 1,205,020 lekësh (2,505,020 - 1,300,000¹⁹), referohuni analizës financiare për vitin 2011, e cila rezultoi në një balancë pozitive.

Sa i takon shlyerjes së kredisë, me dokument lëshuar nga “Alpha Bank”, në datën 24.10.2016, është vërtetuar se shlyerja ka përfunduar në datën 1.12.2011 dhe për shkak të një periudhe shumë të shkurtër deri në fund të vitit, analiza financiare është ajo e kryer për vitin 2011.

Sa i takon interesave bankare të paguara dhe të përfshira në analizën financiare, është vërtetuar se:

- në vitin 2009 janë paguar shpenzime interesash dhe komisione në shumën 276,653 lekë (dhe principal në shumën 99,988 lekë);
- në vitin 2010 janë paguar shpenzime interesash dhe komisione në shumën 250,604 leke (dhe principal në shumën 584,347 lekë);
- në vitin 2011 janë paguar shpenzime interesash dhe komisione në shumën 191,780 lekë (dhe principal në shumën 2,315,666 lekë).

Vlerat e paguara për kredinë (principali, interesat e shpenzimet e tjera të lidhura me kredinë) janë të përfshira në analizën financiare të viteve përkatëse²⁰.

Si burim për këto shlyerje, për periudhën 2009 – 2011, kanë shërbyer të ardhurat vjetore nga: (i) pagat e subjektit dhe bashkëshortes; (ii) shitja e një automjeti; si dhe (iii) huaja prej 1,430,000 lekësh marrë nga babai i subjektit në vitin 2011 (trajtuar në vjim në pikën 1.31).

Nga lëvizjet e llogarisë së kredisë në “Alpha Bank”²¹, është evidentuar se subjekti ka kryer dy derdhje *cash* në datat 10.1.2011 dhe 5.7.2011, përkatësisht në shumat prej 500,000 lekësh në secilën datë, me qëllim shlyerjen e kredisë së tij.

Për depozitimin e shumës në vlerën 500,000 lekë në datën 10.1.2011, bashkëshorti i subjektit, në përgjigje të rezultateve të hetimit si subjekt rivlerësimi, ka deklaruar përdorimin e vlerës 500,000 lekë të krijuara në vitin 2010. Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar shpenzime për shlyerjen e kredisë në shumën 2,505,020 lekë, ku përfshihen këto dy depozitimet prej 500,000 lekësh, por nuk është deklaruar burimi.

Pavarësisht rezultatit financiar të vitit 2011, është kryer analiza financiare mbi mundësinë e subjektit për t’i kryer këto depozitime, në tabelën vijuese.

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga A. Ahmeti, 1.1.2011 - 5.7.2011	442,100
Të ardhura nga paga A. Ahmeti nga mësimdhënia	99,000
Të ardhura nga paga A. Ç, 1.1.2011 - 5.7.2011	553,663
Të ardhura totale, 1.1.2011 – 5.7.2011	1,094,763
Shpenzime jetese 1.1.2011 - 5.7.2011	216,201
Shpenzime transport i brendshëm, 1.1.2011 - 5.7.2011	38,000

¹⁹Nga shuma 1,430,000 lekë transferuar nga babai te subjekti, shuma 1,300,000 ka shkuar për shlyerje kredie, ndërsa shuma 144,000 lekë ka shkuar për krijimin e një depozite-garanci për kartën e kreditit.

²⁰Shihni analizën financiare për vitet 2006 – 2016.

²¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.11.2020, nga “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit.

Shpenzime udhëtimi, 1.1.2011 - 5.7.2011	145,215
Shpenzime për kredinë “Alpha Bank”, 1.1.2011 - 5.7.2011	660,570
Shpenzime totale	1,059,986
Ndryshim likuiditeti, 1.1.2011 - 5.7.2011	-54,837
Mundësi kursimi	89,614

1.31 Në lidhje me mundësinë financiare të personit të lidhur I.Ç

Për dhënien e huas në shumën 1,430,000 lekësh në vitin 2011, sipas detyrimit të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, bashkëshorti i subjektit ka vënë në dispozicion dokumente shkresore që vërtetojnë të ardhura të prindërve të tij si mjekë në qytetin e Lushnjës. Ndërsa, në përgjigjet e pyetësorit të datës 11.2.2020, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se babai I.Ç ka realizuar të ardhura honorarë edhe nga mësimdhënia pranë shkollës së infermierisë “***”, Lushnjë, duke vënë në dispozicion gjendjen bankare në “Union Bank”, për periudhën 1.6.2011 – 1.3.2014. Nga verifikimi u konstatua se të ardhurat nga pagat e I.Ç për vitin 2011, janë në shumën 43,200 lekë, të cilat janë përfshirë si e ardhur në analizën financiare.

Bazuar në dokumentet që vërtetojnë të ardhurat ligjore të familjes Ç, si dhe verifikimet në lidhje me pasuri të tjera të personit të lidhur/I.Ç, është kryer analizë e përmbledhur në tabelën vijuese, për periudhën 2009 – nëntor/2011, ku shpenzimet e jetesës janë llogaritur për katër persona sipas standardit të ILDKPKI-së.

Analiza financiare për mundësinë e dhënies së shumës 1,430,000 lekë

Përshkrimi	Periudha 2009 – 30.11.2011
Të ardhura nga paga I + P.Ç, periudha 2009 – 2011	3,626,638
Total të ardhura	3,626,638
Shpenzime jetese	796,950
Shlyerje kredie në “Alpha Bank”	712,774
Hua dhënë A.Ç në vitin 2011	1,430,000
Total shpenzime	2,939,724
Mundësia financiare për huadhënie 1,430,000 lekë	686,914

Babai i bashkëshortit të subjektit kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për huadhënien në vlerën 1,430,000 lekë në datën 30.11.2011.

Po kështu, nga të dhënat bankare rezultoi se huaja prej 1,430,000 lekësh ka kaluar në emër të subjektit nëpërmjet “Alpha Bank”²² me transfertë bankare nga llogaria nr. *** e prindërve të bashkëshortit të subjektit në llogarinë e subjektit nr. ***, në datën 30.11.2011, me përshkrimin “kalim nga I.Ç tek i biri A.Ç për shlyerje kredie”.

Duke ndjekur origjinën e krijimit të shumës 1,430,000 lekë, nga lëvizjet e llogarisë së prindërve të bashkëshortit të subjektit, evidentohet se:

- Gjatë vitit 2009 janë kryer disa depozitime *cash*, të cilat janë investuar në depozita me afat gjatë vitit. Në fund të vitit 2009, babai i bashkëshortit ka gjendje dy depozita në shumat 356,294 lekë dhe 240,600 lekë.

²²Shihni shkresën me nr. ***, datë 20.11.2020, nga “Alpha Bank”.

- Në datën 30.7.2010 është depozituar shuma 500,000 lekë, e cila i bashkohet dy depozitave të krijuara nga viti i mëparshëm. Në fund të vitit 2010 gjendja e depozitës është në vlerën 1,107,640 lekë.

- Depozita e mësipërme maturohet më 1.8.2011 dhe së bashku me interesat e përfuara dhe të pa tërhequra që prej vitit 2009, formon shumën 1,430,000 lekësh, e cila investohet në depozitë me afat 3-mujor. Në datën 30.11.2011, kur kjo depozitë maturohet, transferohet shuma 1,430,000 lekë te bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

Sa më sipër në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se: (i) huaja në vlerën 1,430,000 lekë ka kaluar në rrugë bankare në llogari të bashkëshortit të subjektit; si dhe (ii) sa i takon mundësisë financiare për krijimin e saj, duket se personi i lidhur I.Ç, ka pasur burime të ligjshme për këtë huadhënie.

1.32 Analizë e detajuar e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë

Për blerjen e apartamentit me sip. 67 m², Tiranë, me numër pasurie ***, në çmimin 60,800 euro, janë përdorur të ardhurat si vijojnë:

a) shuma 20,000 euro është përfitur me kredi bankare në vitin 2009²³;

b) shuma 37,000 euro, paguar në vitin 2008, nga të cilat 18,000 euro janë paguar më 9.9.2008, me burim të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit dhe 19,000 euro më 15.12.2008, nga të cilat 15,000 euro janë deklaruar me burim huadhënien nga prindërit e subjektit dhe bashkëshortit²⁴ dhe pjesa tjetër me të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit.

1) U verifikuan DPV-të e subjektit dhe bashkëshortit për vitin 2007, në të cilat është deklaruar përkatësisht: (i) nga bashkëshorti në rubrikën “ndryshimet e interesave private” janë deklaruar “kursime në gjendje cash, shtuar me shumën 100,000 lekë”, (ii) nga subjekti në rubrikën “deklarimi i interesave private” janë deklaruar “kursime në gjendje cash në shumën 50,000 lekë”.

2) U verifikuan DPV-të për vitin 2008, ku janë deklaruar përkatësisht: (i) nga bashkëshorti janë deklaruar “kursime në gjendje cash, pakësuar në shumën 400,000 lekë, vlera aktuale 0 (zero) lekë”; (ii) nga subjekti janë deklaruar “kursime pakësuar në zero”.

3) Është pyetur bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për të paguar shumën prej 22,000 euro dhe, në përgjigjet e pyetësorit të datës 26.5.2020, ka deklaruar se të ardhurat kanë qenë me burim nga: (i) bursa si magjistrat; (ii) paga si prokuror për periudhën nëntor 2006 – dhjetor 2008; (iii) kursime të krijuara nga subjekti Arbena Ahmeti, përpara fillimit të detyrës si gjyqtare dhe përpara martesës, me burim: paga si juriste në Bashkinë Tiranë, bursa si magjistrate, si dhe depozitat bankare, në emër të saj; (iv) paga si gjyqtare e subjektit Arbena Ahmeti, në periudhën nëntor 2006 – dhjetor 2008.

Në përfundim, nga verifikimi i dokumenteve shkresore të administruara, u vërtetua se për pagimin e shumës 22,000 euro, subjekti dhe bashkëshorti kanë përdorur konkretisht: (i) likuiditetin në shumën 1,549,651 lekë, përbërë nga 450,000 lekë cash të deklaruar si gjendje në fund të vitit 2007 (400.000 lekë + 50.000) plus likuiditete në bankë në shumën 1,099,651 lekë; (ii) të ardhurat nga pagat në shumën 1,819,682 lekë. Këto të ardhura nga burime të ligjshme janë përfshirë në analizën financiare për vitin 2008, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese, në të cilën nuk është përfshirë huaja në shumën 10,000 euro dhe as huaja prej 5,000 euro.

²³Problematikat lidhur me këtë kredi janë trajtuar më sipër në pikën 1.30.

²⁴Lidhur me mundësitë e këtyre huadhënieve nga personat e tjerë të lidhur janë trajtuar në pikën 1.35 të këtij vendimi.

Shpenzimet e jetesës janë llogaritur për dy persona. Analiza është ndarë në dy pjesë. Janë analizuar më vete mundësia financiare e pagesës së vlerës 18,000 euro në datën 9.9.2008 dhe mundësia financiare e pagesës së vlerës 19,000 euro më 15.12.2008.

Ndërkohë, duhet theksuar se në DPV-në e vitit 2008 deklarohet se gjendja e kursimeve *cash* është 0 (zero), por nuk deklarohet përdorimi i gjendjes *cash*. Megjithatë në analizën financiare të mundësisë së pagesës së kështit prej 18,000 euro, në datën 9.9.2008 është konsideruar si burim edhe pakësimi i kursimeve *cash* nga viti 2007.

Analiza e mundësisë së pagesës së kështit në vlerën 18,000 euro, në datën 9.9.2008

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga A. Ahmeti, 1.1.2008 - 9.9.2008	622,789
Të ardhura nga paga A. Ç, 1.1.2008 - 9.9.2008	620,709
Të ardhura totale 1.1.2008 - 9.9.2008	1,243,499
Paguar shuma 18,000 euro, për blerje apartamenti më 9.9.2008	2,217,285
Shpenzime jetese, 1.1.2008 - 9.9.2008	188,991
Shpenzime udhëtimi, 1.1.2008 - 9.9.2008	246,365
Shpenzime totale	2,652,641
Ndryshim likuiditeti, 1.1.2008 - 9.9.2008	-1,475,245
Mundësi kursimi	66,103

Subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi financiare për pagesën e kështit 18,000 euro, në datën 9.9.2008 për blerjen e apartamentit, si dhe përballimin e shpenzimeve të tjera.

Komisioni hartoi analizën financiare për mundësinë e pagesës së kështit me vlerë 19,000 euro, në datën 15.12.2008 dhe në bazë të kësaj analize rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur burime të ligjshme për pagesën e kështit me vlerë 19,000 euro për blerje apartamenti në datën 15.12.2008, si dhe përballimin e shpenzimeve të tjera në vlerën prej 1,820,043 lekë.

1.33 Në përfundim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës.

- Subjekti nuk ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të paguar shumën në vitin 2008 për blerjen e apartamentit, për shkak të një balance negative prej 1,820,043 lekësh.

1.34 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: *“Kërkoj që prej trupit gjykues, duke qenë se mendoj që si më lart shterova detyrimin për barrën e provës, që në analizë financiare të përfshihen edhe shuma monetare, gjithsej 15,000 euro, e marrë në total në hua, prej prindërve respektivë, të bashkëshortit dhe të mitë.*

Po kështu, të rillogaritet në analizë financiare dhe përdorimi i ligjshëm i të gjendjes monetare në formën cash, të deklaruar në DVP-në e vitit 2015, me të ardhura prej pagave respektive, si burim pagesash detyrimesh tona si dhe burim për blerjen e automjetit në vitin 2016”.

1.35 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe bashkëshorti arriti të provojë dhe të vërtetojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me mundësitë financiarë të huadhënësve për vlerat 10,000 euro dhe 5,000 euro. Në këtë vlerësim, Komisioni mori në konsideratë çështjen e përfunduar të bashkëshortit të subjektit (subjekt rivlerësimi) me vendimin nr. ***, datë 23.3.2021²⁵ (vendim i formës së prerë).

1.36 Në përfundim, Komisioni hartoi analizën financiare për mundësinë e pagesës së kështit në vlerën 19,000 euro, në datën 15.12.2008, nga subjekti dhe bashkëshorti.

²⁵Shihni vendimin nr. ***, datë 23.3.2021, të Komisionit, për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

Analiza e mundësisë së pagesës së këstit 19,000 euro, në datën 15.12.2008

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga A. Ahmeti, 10.9.2008 – 15.12.2008	266,765
Te ardhura nga paga A. Ç, 10.9.2008 – 15.12.2008	322,746
Hua nga N.T, në shumën 10,000 euro	1,231,825
Hua nga I.Ç, në shumën 5,000 euro	615,913
Të ardhura totale 10.9.2008 - 15.12.2008	2,437,249
Paguar 19,000 euro për blerje apartamenti, datë 15.12.2008	2,340,468
Shpenzime jetese, 10.9.2008 - 15.12.2008	72,864
Shpenzime totale	2,413,332
Ndryshim likuiditeti 10.9.2008 - 15.12.2008	-3,777
Pamundësi kursimi	27,694

Në bazë të analizës financiare, rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kishin mundësi financiare për shlyerjen e këstit në vlerën 19,000 euro.

a) Sa i takon këstit në vlerën 3,643 euro, nga hetimi administrativ rezultoi se ky këst është paguar në datën 24.4.2010. Në vijim është analizuar mundësia financiare e pagesës së këtij kësti nga subjekti dhe bashkëshorti.

Analiza e mundësisë së pagesës së këstit në vlerën 3,643 euro, në datën 24.4.2010

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga A. Ahmeti, 1.1.2010 - 24.4.2010	353,661
Të ardhura nga paga A. Ç, 1.1.2010 - 24.4.2010	293,747
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”	450,000
Të ardhura totale 1.1.2010 - 24.4.2010	1,097,408
Paguar 3,643 euro për blerje apartamenti datë 24.4.2010	505,685
Shpenzime jetese, 1.1.2010 - 24.4.2010	136,620
Shpenzime transport i brendshëm, 1.1.10 - 24.4.2010	9,200
Shpenzime për kredinë në “Alpha Bank”, 1.1.2010 - 24.4.2010	611,558
Shpenzime totale	1,263,063
Ndryshim likuiditeti 1.1.2010 - 24.4.2010	-289,213
Mundësi kursimi	123,558

Subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e këstit në vlerën 3,643 euro për blerjen e apartamentit në datën 24.4.2010, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera.

1.37 Në përfundim, Komisioni, për të gjitha gjetjet e mësipërme lidhur me pasurinë apartament, huat e pretenduara dhe provueshmërinë për burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë dhe mundësitë financiare të huadhënësve, i kaloi subjektit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

1.38 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se: *“Në interpretim të fakteve të provuara, si më sipër dhe dispozitave ligjore të ligjit me nr. 84/2016, prindërit, si persona të tjerë të lidhur në raport me mua, në cilësinë e huadhënësve, provojnë se shumën monetare prej 10,000 euro dhe 5,000 euro, në fund të vitit 2008, e kanë krijuar me burime të ligjshme. Ligji nr. 84/2016, në mënyrë të shprehur, kërkon të provohet ligjshmëria e burimit për krijimin e shumës monetare*

prej personave të tjerë të lidhur, në këtë rast, prindërit e mi dhe të bashkëshortit tim dhe këtë detyrim ligjor unë si subjekt i rivlerësimit e shterova tërësisht, si më lart. Analiza financiare, bazuar në të ardhura të ligjshme, bëhet sipas ligjit nr. 84/2016 vetëm për personat e lidhur të subjektit, për të provuar ligjshmërinë e pasurive, në pronësi apo në përdorim, por jo për personat e tjerë të lidhur. Pra, ligji nr. 84/2016 përcakton kufijtë e hetimit të pasurive të personave të tjerë të lidhur të subjektit të rivlerësimit.

Në këtë interpretim të ligjit është ndaluar edhe Komisioni i Posaçëm i Apelit, në vendimin nr. 15, datë 17.7.2019.²⁶ Kolegji i Apelit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme (paragrafi 2, i nenit 66, i ligjit nr. 84/2016).

Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që, përgjithësisht, nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit dhe, për më tepër, duket edhe i pamundur²⁷”.

Pra, praktika gjyqësore kushtetuese e KPA-së, por edhe praktika vendimmarrëse e KPK-së, në raste të vendosura prej saj, ka ndjekur këtë standard, duke e kufizuar objektin e verifikimit me personat e lidhur dhe jo ndaj personave të tjerë të lidhur”.

Vlerësimi i Komisionit

1.39 Bazuar në provat dhe shpjegimet e dhëna prej subjektit, vlerësohet se, në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti arriti të shpjegojë në lidhje me pamundësinë e nënës së saj, znj. N.T, për të justifikuar me të ardhura të ligjshme dhënien e huas në shumën 10,000 euro, në vitin 2008, shumë e cila u përfshi si e ardhur e ligjshme në analizën financiare përfundimtare. Në fund të vitit 2008 personi tjetër i lidhur, znj. N.T dhe familja e saj, kanë pasur të ardhura në shumën 2,352,809 lekë. Këto të ardhura u konsideruan nga Komisioni si të mjaftueshme për të dhënë shumën e huas në vlerën 10,000 euro në vitin 2008 subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

1.40 Ndërsa në lidhje me barrën e provës për pamundësinë e babait të bashkëshortit të subjektit, z. I.Ç, për të justifikuar me të ardhura të ligjshme dhënien e huas në shumën 5,000 euro në vitin 2008, Komisioni ka marrë në konsideratë vendimin nr. ***, datë 23.3.2021, për përfundimin e procesit të rivlerësimit të bashkëshortit të subjektit, A.Ç, prandaj kjo shumë u përfshi si e ardhur e ligjshme në analizën financiare përfundimtare.

Në vendimin me nr. ***, datë 23.3.2021, marrë formë të prerë është konkluduar se:

“1. Bazuar në këto pretendime, janë rishikuar shpenzimet e jetesës, fakt që ka ndikuar në analizën financiare përfundimtare për periudhën 2007 – 2008, pasqyruar në tabelën vijuese, që pasqyron balancë pozitive, në vlerën 56.260, në përfundim.

2. Komisioni çmon se me të drejtë subjekti i është referuar qëndrimin të Kolegjit, por nënvizon faktin që në rastin konkret subjekti ka deklaruar marrjen e huas në vlerën 5,000 euro në dhjetor të vitit 2008, ndërkohë që kontratat për blerjen e dy apartamenteve të banimit prej babait të tij, z. I.Ç, janë redaktuar pak kohë më parë se dhënia e huas, përkatësisht, në datat 26.8.2008 dhe 24.10.2008. Për këtë arsye, përfshirja e këtyre pasurive në analizën financiare për të verifikuar mundësinë e dhënies

²⁶Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë burim i së drejtës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

²⁷Cituar paragrafi 110 i përmbajtjes së vendimit me nr. ***, datë 17.7.2019, të Kolegjit.

së huas në vlerën 5,000 euro në dhjetor të vitit 2008, ka qenë sa e pashmangshme, aq edhe e domosdoshme.

3. Përveç kësaj, hetimi i kryer nga Komisioni, si dhe provat e paraqitura nga subjekti në ushtrim të barrës së provës, vërtetuan në mënyrë shteruese se nuk ka asnjë lidhje midis subjektit dhe dy pasurive të blera në qytetin e Lushnjës nga babai i tij I.Ç, në cilësinë e personit tjetër të lidhur.

4. Për më tepër, u vërtetua se pagesat për blerjen e këtyre apartamenteve nuk janë kryer brenda vitit 2008, kur është dhënë huaja në vlerën 5,000 euro, por në vitet 2006 dhe 2007, pjesërisht kur subjekti nuk ka qenë në detyrë dhe pjesërisht brenda një viti që ai ka filluar detyrën si prokuror. Bazuar në të gjitha sa më sipërshtetuar, në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti arriti të kundërshtojë bindshëm barrën e provës në lidhje me pamundësinë e babait të tij, z. I.Ç për të justifikuar me të ardhura të ligjshme dhënien e huas në shumën 5,000 euro në vitin 2008, shumë e cila u përfshi si e ardhur e ligjshme në analizën financiare përfundimtare”.

1.41 Komisioni vlerëson se procesi kushtetues i rivlerësimit duhet të jetë një proces i pavarur, për secilin subjekt që i nënshtrohet, nga subjekte të tjera të procesit të rivlerësimit, por që janë në marrëdhënie familjare midis tyre, në të tria kriteret. Në të tilla rrethana, secili trup gjykues është i pavarur të ushtrorë kompetencat e dhëna në Kushtetutë dhe në ligjin me nr. 84/2016 në të gjitha fazat e procesit të rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ, me anë të gjetjeve dhe kalimin e barrës së provës subjektit përkatës të rivlerësimit, sipas rasteve të ligjit, por edhe në vlerësimin përfundimtar të rrethanave dhe provave. Njëherësh është detyrë e çdo trupi gjykues të mbajë në konsideratë, që për të njëjtat fakte të provuara me të njëjtat prova, në arsyetim përfundimtar t’i referohet parimit të gjyqimit për “gjënë e gjykuar”. Prandaj, në këtë rast, Komisioni arrin në përfundimin se në gjykim u provua se, ndodhet përballë situatës ligjore të përcaktuar në nenin 451/a të Kodit të Procedurës Civile: “Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohej përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe”.

1.42 Referuar ligjit nr. 84/2016, Komisioni, për gjykimin e tij, zbaton rregullat e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili përcakton në paragrafin e dytë të nenit 1 se dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

1.43 Në jurisprudencën kushtetuese, parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e të drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jetë kryer me qëllim dhënia e vendimit gjyqësor dhe t’i përkasë fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjyqimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (shihni vendimin nr. 24, datë 12.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese). Për sa më sipër, parimi i gjësë së gjykuar (*res judicata*), pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (shihni vendimet: nr. 23, datë 8.6.2007 dhe nr. 12, datë 17.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese).

1.44 Bazuar në të gjitha faktet dhe provat si më sipër, Komisioni nuk evidentoi asnjë problematikë dhe dyshim sa i takon huas në vlerën 1,430,000 lekë, dhënë nga z. I.Ç, referuar provave dhe rrethanave, si vijojnë:

- i) kjo hua ka kaluar në llogari të subjektit me transfertë bankare të datës 30.11.2011;
- ii) huaja është deklaruar në DPV-në e vitit 2011, me qëllim shlyerjen e detyrimit të shumës 2,505,020 lekë ndaj “Alpha Bank”;
- iii) nga shuma e dhënë hua, pjesa prej 1,300,000 lekësh është përdorur për të mbyllur kredinë më 1.12.2011;
- iv) personi tjetër i lidhur/I.Ç ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të dhënë këtë hua, në kuptim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe orientimit të Kolegjit, sipas vendimit nr. ***, datë 17.7.2019, të cilit subjekti i referohet.

1.45 Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në sa më sipër, u vërtetua se për pagimin e shumës 22,000 euro ose 2,710,015 lekë, subjekti ka pasur burime të justifikuara ligjërisht nga pagat dhe kursimet, të përfshira në analizën përfundimtare.

1.46 Në përfundim të procesit të rivlerësimit, huat e marra nga subjekti dhe bashkëshorti janë përfshirë si të ardhura të ligjshme për shkak se subjekti vërtetoi të kundërtën e barrës së provës.

1.47 Në vlerësimin përfundimtar, për këtë pasuri, Komisioni mori në konsideratë çështjen e përfunduar të bashkëshortit të subjektit (subjekt rivlerësimi) me vendimin nr. ***, datë 23.3.2021²⁸, (vendim i formës së prerë).

1.48 Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se subjekti ka kryer deklarime të sakta dhe në përputhje me ligjin si në DPV-të përkatëse ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, si dhe ka justifikuar blerjen e pasurisë me të ardhura të ligjshme.

2. Automjet tip “Daimler Chrysler * B *** CDI”, me vlerë 3,000 euro**

2.1 Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar automjet me nr. shasie ***, me naftë, 5 vende, me vlerë 3,000 euro, me pjesë takuese 50%, blerë sipas kontratës së shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 30.3.2016.

Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat e të dy bashkëshortëve.

Hetimi i Komisionit

2.2 Në lidhje me këtë pasuri, nga dokumentet e vëna në dispozicion nga ILDKPKI-ja²⁹ dhe DPSHTRR-ja³⁰ rezultoi se me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 30.3.2016, subjekti Arbena Ahmeti, në mungesë, e përfaqësuar në bazë të nenit 648 të Kodit Civil nga vëllai i saj z. D.A, ka blerë nga shtetasja J.B automjetin në vlerën 3,000 euro, i cili figuron i regjistruar në emër të saj. Neni 648 i Kodit Civil përcakton: “Personi që, pa qenë i detyruar, merr përsipër me ndërgjegje dhe për një qëllim të arsyeshëm gjerimin e punëve ose interesave të tjetrit, është i detyruar ta vazhdojë atë derisa personi i interesuar të jetë në gjendje të kujdeset vetë”.

2.3 Në deklarimin për vitin 2016 subjekti ka deklaruar: “Blerë automjet tip “***”, ***, nr. shasie ***, me naftë, 5 vende. Vlera: 3,000 euro. Pjesa takuese: 50%”. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

2.4 Komisioni hartoi analizën financiare deri në momentin e blerjes së automjetit, datë 30.3.2016. Nga kjo analizë rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur burime të ligjshme të

²⁸Shihni vendimin nr. ***, datë 23.3.2021, të Komisionit, për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

²⁹Shihni aktet në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁰Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.10.2018, nga DPSHTRR-ja dhe shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.10.2018, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

mjaftueshme për blerjen e automjetit në shumën 3,000 euro, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera të periudhës dhe të shtojnë likuiditetin në vlerën 256,825 lekë.

2.5 Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit lidhur me:

- subjekti ka qenë në pamundësi financiare për blerjen e pasurisë automjet në datën 30.3.2016, me burim të ardhura nga paga;
- subjekti nuk ka deklaruar, në DPV-në e vitit 2016, burimin e krijimit të kësaj pasurie, detyrim i parashikuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- kjo pasuri rezultoi e blerë nga shtetasi D.A (vëllai i subjektit), në mungesë të subjektit të rivlerësimit, dhe pa prokurë të lëshuar prej saj.

2.6 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: “Në lidhje me përcaktimin që është konstatuar pamundësi financiare për blerjen e pasurisë automjet në datën 30.3.2016, sjell vëmendje të trupit gjykues se analiza financiare përkatëse nuk merr në shqyrtim gjendjen financiare të disponueshme në formën cash, të deklaruar në DVP-në e vitit 2015, e mbartur në datën 1.1.2016.

Referuar përmbajtjes së DVP-së së viteve 2015 dhe 2016 nis me disponimin nga ana jonë e një gjendjeje likuiditeti cash, në banesë, prej 200,000 lekësh, e cila ka shërbyer së bashku me të ardhurat e realizuara nga pagat tona, deri në atë moment.

Ndërsa transaksioni për blerjen e automjetit ka ndodhur në mes të vitit deklarues 2016, gjendja cash deklarohet në përfundim të periudhës deklaruese, pra të vitit deklarues 2015 në këtë rast dhe që në mënyrë logjike, e njëjta vlerë e deklaruar në datën 31.12.2015 është e mbartur si vlerë dhe në vitin pasardhës vijues deklarues, në datën 1.1.2016, ku shuma është e njëjta me datën 31.12.2015, por për vitin 2016 deklarimi bëhet për këtë gjendje në fund të vitit, duke deklaruar shtesa apo pakësime. Është i vërtetë konstatimi që ‘në rubrikën përkatëse të DVP-së së vitit 2016’ nuk është shënuar burimi i krijimit të pasurisë së luajtshme që regjistrohet, duke qenë një lapsus.

Ndërkohë, burimi i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar në deklaratën Vetting të dorëzuar prej meje, në muajin janar të vitit 2017, përpara dorëzimit të DVP-së së vitit 2016, që është dorëzuar në muajin mars të vitit 2017 (dy muaj më pas) ndaj si më sipër, është deklaruar saktë, burimi i krijimit të kësaj pasurie, në ILDKPKI. Për blerjen e automjetit kam autorizuar me prokurë të posaçme noteriale, që të më përfaqësojë vëllai im. Prokura është lëshuar para të njëjtit noter publik që ka përpiluar kontratën e shitblerjes së automjetit. Unë nuk disponoj aktualisht kopje të kësaj prokure”.

2.7 Pas shpjegimeve të sjella nga subjekti lidhur me mundësinë financiare për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni mori parasysh edhe gjendjen cash të deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2015. Në përfundim, Komisioni hartoi analizën financiare si në tabelën vijuese.

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 3,000 euro, më 30.3.2016

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga A. Ahmeti 1.1.2016 - 30.3.2016	259,244
Të ardhura nga paga A. Ç 1.1.2016 - 30.3.2016	316,197
Të ardhura totale 1.1.2016 - 30.3.2016	575,441
Paguar 3,000 euro për blerje automjeti datë 30.3.2016	405,810
Shpenzime jetese 1.1.2013 – 30.3.2016	176,319
Shpenzime udhëtimi 1.1.2016 - 30.3.2016	33,818
Shpenzime mjekësore 1.1.2016 - 30.3.2016	60,000
Shpenzime për shkollimin e vajzës 3 muaj	128,507

Shpenzime totale	804,453
Ndryshim likuiditeti periudha 1.1.2013 – 30.3.2016	-172,187
Pamundësi kursimi	-56,825

Bazuar në këtë analizë, rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kanë një pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera në vlerën 56,825 lekë, që për Komisionin nuk konsiderohet penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

Vlerësimi i Komisionit

2.8 Bazuar në të gjitha sa më sipërshtetuar, në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti arriti të kundërshtojë bindshëm barrën e provës në lidhje me pamundësinë financiare për blerjen e kësaj pasurie.

2.9 Rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë automjet me 30.3.2016, me burim të ardhurash edhe nga gjendja cash.

2.10 Subjekti nuk ka deklaruar, në DPV-në e vitit 2016, burimin e krijimit të kësaj pasurie, detyrim i parashikuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, por Komisioni vlerëson se subjekti e ka deklaruar burimin e kësaj pasurie në deklaratën Vetting.

2.11 Në vlerësimin përfundimtar për këtë pasuri, Komisioni mori në konsideratë çështjen e përfunduar të bashkëshortit të subjektit (subjekt rivlerësimi) me vendimin nr. ***, datë 23.3.2021 (vendim i formës së prerë).

2.12 Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se subjekti ka kryer deklarin të saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratën Vetting për këtë pasuri, si dhe ka justifikuar blerjen e pasurisë me të ardhura të ligjshme.

3. Likuiditet në vlerën 500,000 lekë, dhënë nënës, znj. N.T

3.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën Vetting se ka dhënë hua, pa afat dhe pa interes nënës, znj. N.T, sipas marrëveshjes verbale të vitit 2014.

3.2 Burimi i krijimit: (a) të ardhura nga paga e subjektit si gjyqtare dhe paga e bashkëshortit si prokuror; (b) tërheqja e shumës së depozituar (kursimet) në “Tirana Bank”.

Hetimi i Komisionit

3.3 Në lidhje me këtë likuiditet, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se me deklaratën noteriale nr. *** prot., datë 25.1.2017, shtetasja N.T deklaroi se në vitin 2014, për nevojat e saj, ka marrë një hua prej vajzës dhe bashkëshortit A.Ç në shumën 500,000 lekë, pa afat dhe pa interes, dhe ende nuk e ka shlyer këtë shumë të marrë hua. Nuk është përcaktuar data e saktë e marrjes së huas në shumën 500,000 lekë.

3.4 Në DPV-në e vitit 2014, nga subjekti është deklaruar huadhënie në shumën 500,000 lekë, pa afat dhe pa interes nënës Nurisha Topulli, shumë kjo e siguruar nga tërheqja e shumës së depozituar në “Tirana Bank” dhe kursimet nga paga. Pas verifikimit nga kjo bankë³³, ka rezultuar se në datën 4.12.2014, bashkëshorti A.C ka tërhequr nga llogaria e tij pranë kësaj banke shumën 353,856 lekë.

³¹Shihni vendimin nr. ***, datë 23.3.2021, të Komisionit për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

³²Shihni aktin në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2018 nga “Tirana Bank”.

3.5 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti deklaroi se huan prej 500,000 lekësh ia ka dhënë nënës së saj në dhjetor të vitit 2014.

3.6 Nga analiza financiare e vitit 2014, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme edhe për dhënien e huas në vitin 2014, hua e cila nuk është shlyer nga znj. N.T, sikurse subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

4. Pasuria e bashkëshortit të subjektit A.Ç

Bashkëshorti i subjektit A.Ç ka deklaruar të njëjtat pasuri si subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti.

5. Konstatime të tjera

1. Në DPV-në e vitit 2006, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar një automjet tip “Mercedes-Benz” në vlerën 500,000 lekë, blerë me të ardhura të dhuruara nga babai I.Ç.

Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar: *“Ju vë në dispozicion të skanuara praktikën e kontratës noteriale të shitjes së automjetit nr. **, datë 15.2.2010, të lidhur midis bashkëshortit tim, z. A.Ç, në cilësinë e palës shitëse dhe z. F.K, në cilësinë e palës blerëse, për çmimin e shitjes prej 450,000 lekësh. Kam mundur të gjej vetëm këtë dokument dhe praktikën bashkëlidhur kësaj kontrate, sipas arkivës që ka ruajtur noteri publik. Unë dhe bashkëshorti im nuk disponojmë kontratën e blerjes së automjetit, pasi kjo pasuri është fituar prej bashkëshortit tim përpara lidhjes së martesës tonë dhe përpara fillimit në detyrë të tij, por edhe ka kaluar një kohë shumë e gjatë prej humbjes së pronësisë së automjetit, nga viti 2010 dhe aktualisht. Kjo pasuri është deklaruar në DVP përpara fillimit të detyrës prej bashkëshortit tim, si subjekt deklarues dhe në DVP-të vjetore përkatëse, në vlerën e saj totale prej 500,000 lekësh, ku kanë qenë të përfshira çmimi i blerjes dhe çdo shpenzim tjetër targimi, zhdoganimi etj.”.*

Duke qenë që kjo pasuri është krijuar nga bashkëshorti i subjektit para martesë, nga Komisioni nuk kanë lindur dyshime për këtë pasuri.

Të ardhurat nga shitja e këtij automjeti janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2010.

2. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se znj. N.T, nëna e subjektit, ka porositur pranë shoqërisë “***” sh.p.k., një apartament banimi në vitin 2014, në shumën 114,170 euro, me kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 27.8.2014. Komisioni kreu disa veprime verifikuese me qëllim heqjen e çdo dyshimi mbi pronësinë ose posedimin e mundshëm të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

Subjekti i rivlerësimit është pyetur për këtë çështje dhe, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, ka deklaruar: *“Nënës i nevojitej shuma për nevoja të familjes në atë kohë. Më kërkoi ndihmë, nuk më ka përcaktuar shprehimisht për çfarë i donte ato para. Kjo pasuri nuk është përdorur dhe as poseduar prej meje apo familjes time. Unë nuk kam kontribuar në asnjë formë dhe mënyrë në blerjen e saj. Specifikoj se nëna e ka lidhur kontratën e porosisë në muajin gusht të vitit 2014, e cila është në emër të saj, por kanë kontribuar të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes. Ndërsa, bashkëshorti im dhe unë i kemi dhënë huan nënës në muajin dhjetor të vitit 2014, pra disa muaj më pas lidhjes së kontratës. Gjatë procesit të rivlerësimit, bashkëshorti im, si pjesë e hetimit administrativ, është pyetur prej trupit gjykues mbi të njëjtat çështje dhe ka paraqitur shpjegime dhe dokumentacion përkatës, i qëndroj atyre pasi kam të njëjtat shpjegime dhe kërkuj prej jush të administrohen të njëjtat dokumente, që ka paraqitur bashkëshorti.”.*

Në shpjegimet përkatëse është detajuar çdo e ardhur me dokumentacion justifikues për secilin prej anëtarëve madhorë të familjes së nënës time, që posedojnë shtëpinë përkatëse. Ju lutem, të merrni të njëjtin dokumentacion që ka depozituar edhe bashkëshorti im, pasi ndjehem në vështirësi t’u kërkuj sërish familjarëve të mi të më japin dokumente për shtëpinë e tyre dhe të ardhura të tyre. Siç

edhe ju shpjegova më lart, motra dhe vëllai janë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëna është e moshuar”.

Komisioni, në përfundim të hetimit, nuk konstatoi problematika për këtë pasuri.

3. Në deklarinimin për vitin 2007, subjekti (e cila është martuar në janar të vitit 2007) ka deklaruar llogari bankare në shumën 780,000 lekë dhe 3,800 USD, në total prej 1,095,514 lekësh. Por, ndërsa likuiditeti i mbartur prej subjektit në ekonominë bashkëshortore pas martesë është 1,021,803 lekë³⁴, si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të vitit 2007 është përfshirë vetëm shuma 905,275 lekë, pasi për shumën e dhuruar nga babai i saj prej 1,244 USD/116,528 lekë, nuk ka mundur të provojë me dokumentacion burimin e ligjshëm.

Në tabelën vijuese është treguar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shumën 905,275 lekë, para martesës.

Përshkrimi	2004	2005	2006	Total
Juriste në Bashkinë Tiranë	163,016			163,016
Magjistrate në Shkollën e Magjistraturës	116,325	465,300	350,805	932,430
Gjyqtare në Gjykatën e Tiranës			208,040	208,040
Total të ardhura	279,341	465,300	558,845	1,303,486
Shpenzime jetese	93,964	109,557	109,557	313,078
Mundësia për kursim	185,377	355,743	449,288	990,408

4. Në datën 13.3.2006, në llogarinë e subjektit në “Tirana Bank”, shtetasja M.S ka derdhur shumën prej 35,039 USD, shumë e cila është tërhequr nga subjekti në datën 17.3.2006. Lidhur me këtë konstatim është pyetur bashkëshorti i subjektit, i cili është përgjigjur se: “Shtetasja shqiptaro-amerikane, znj. M.S, është tezja ime (motra e nënës), emri i familjes së origjinës është M.P (aktualisht ajo mban këtë mbiemër, pasi ka zgjidhur martesën). Në muajin mars të vitit 2006 unë dhe bashkëshortja kemi qenë të fejuar (martesa është lidhur në janar të vitit 2007) dhe ajo ishte e vetmja nga familja jonë që kishte një llogari të hapur në monedhën dollar amerikan, në bankën e nivelit të dytë. Bashkëshortja ime, znj. Arbena Ahmeti, është dekretuar gjyqtare në shkallën e parë, në datën 4.10.2006, me Dekret të Presidentit të Republikës. Shuma e parave prej 35,039 USD është tërhequr prej bashkëshortes sime për t’ia kaluar më pas mamasë sime, znj. P.Ç (P), pasi ky ishte qëllimi i transaksionit dhe mamaja ime nuk kishte llogari bankare, në dollar”. Bashkëngjitur ka paraqitur kopje të akteve të gjendjes civile për të provuar lidhjen familjare sipas shpjegimit të dhënë më sipër.

Pas verifikimit në sistemin TIMS rezulton që znj. M.P (S) është shtetase amerikane. Ky fakt, vërtetimi i tërheqjes së shumës nga subjekti katër ditë pas derdhjes, si dhe fakti që kjo shumë nuk është përdorur dhe deklaruar si burim për blerjen e ndonjë pasurie nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, i bëjnë të besueshme pretendimet e subjektit dhe bashkëshortit.

5. Gjatë viteve 2014 dhe 2015 janë konstatuar disa derdhje mujore në llogarinë bankare të subjektit nga fondacioni “****”, si vijon:

³⁴Shuma 1,021,803 lekë është totali i likuiditeteve të znj. Arbena Ahmeti në fund të vitit 2006 i përbërë nga gjendja *cash* dhe gjendje në llogaritë bankare të saj. Ky total është krijuar nga: shuma 1.244 USD e dhuruar nga babai i saj dhe shuma 905,275 lekë e krijuar nga kursimet e të ardhurave të znj. Arbena Ahmeti, para martesës.

Data	Shuma në lekë
11.9.2014	22,000
16.10.2014	22,000
17.11.2014	22,000
16.12.2014	22,000
16.1.2015	22,000
16.2.2015	44,000
16.4.2015	44,000
17.6.2015	22,000
TOTAL	220,000

me përshkrimin “*by order of *** - kthim pagese E.Ç*”. Është vënë re se në të njëjtën datë të kreditimit, subjekti ka bërë pagesë në të njëjtën shumë për fondacionin “***”.

Për këto shuma është pyetur bashkëshorti i subjektit, i cili në përgjigjet e pyetësorit nr. *** ka sqaruar se *fondacioni “***”, në bashkëpunim me BKT-në, kanë pajisur të gjithë prindërit e fëmijëve për pagesë me kartë studenti, me anë të cilës duhet të bëhej pagesa mujore. Më tej, bashkëshorti i subjektit sqaron se të gjitha pagesat, që rezultojnë të kthyera nga fondacioni “***” në llogarinë e tij janë pagesa që janë kryer nga ana e tij ditë më parë në llogari të fondacionit dhe jo te numri i llogarisë së kartës personale. Pra, kthimi është bërë që më pas e njëjta shumë të kalonte në llogarinë e kartës, që të merrej pagesa nga sistemi, sipas mënyrës së pagesave.*

Pretendimet vërtetohen edhe me aktet bankare “depozitim *cash*” në BKT të depozituara prej tij. Këto sqarime përputhen me përgjigjen e dhënë nga fondacioni “***”³⁵, i cili ka sqaruar marrëveshjen e bërë me BKT-në, ku çdo prindi do i hapej një kartë krediti për fëmijën nga banka. Sipas kësaj marrëveshjeje, çdo datë 2 të muajit do të kalonte këstin për çdo nxënës në shumën 22,000 lekë në llogarinë e fondacionit “***”, pastaj prindërit kishin kohë deri në datën 16 të muajit përkatës të kryenin pagesën e këstit në fjalë te llogaria e kartës së kreditit. Gjithashtu, fondacioni “***” ka vënë në dispozicion kontratë dorëzanie nr. ***, datë 23.1.2016, me palë dorëzanes fondacionin “***” dhe kredidhënës BKT-në.

Në analizën financiare janë përfshirë vlerat e dokumentuara të pagesave të bëra për shkollimin e fëmijëve.

6. Në deklaratat periodike të viteve 2007 – 2010 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vendndodhje pallatin e ri, pa numër, në bulevardin kryesor përballë Postës Shqiptare Lushnjë. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: “*Në periudhën shtator 2007 – tetor 2010, duke qenë se jam emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, së bashku me bashkëshortin kam qëndruar në banesë, pronë e prindërve të tij, në qytetin e Lushnjës, adresa e së cilës është pasqyruar në deklaratimet periodike të pasurisë, me adresë: lagjja ‘***’, z. k. ****”.

Nga hetimi rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. ***, babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. I.Ç, ka blerë pasurinë apartament 2+1, me sip. 106.34 m², në shumën 4,143,480 lekë.

Gjithashtu, babai i bashkëshortit I.Ç, me kontratën e shitblerjes nr. ***, në datën 26.8.2008, ka blerë edhe pasurinë apartament me vlerë 3,200,000 lekë.

Të dyja këto pasuritë janë blerë gjatë ushtrimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit dhe nuk janë deklaruar si pasuri në përdorim në deklaratën *Vetting* dhe as burimi i krijimit të tyre.

³⁵Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.7.2019, nga fondacioni “***”, në dosjen e Komisionit.

Lidhur me mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur, babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, u hartua analiza financiare ku rezultoi pamundësi financiare për blerjen e këtyre pasurive (lidhur me pamundësinë, referojuni analizës financiare më sipër në pikën 1/8c).

Subjekti duhet të deklarojë pasuritë në përdorim dhe burimin e ligjshëm të krijimit sipas nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit si më sipër.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: *“Kjo banesë është porositur nga babai i bashkëshortit dhe paguar prej tij përpara fillimit të punës nga ana e bashkëshortit tim dhe përpara lidhjes së martesës sonë. Qëndrimi në këtë banesë nga ana jonë ka qenë rastësor dhe i përkohshëm. Kjo pasi emërimi ynë në qytetin e Lushnjës ka ndodhur pa pëlqimin tonë edhe pse kemi depozituar në institucionet e martesës, certifikatën e martesës së lidhur në fillim të vitit 2007(emërimi është bërë në tetor të vitit 2007). Të ndodhur përpara këtij fakti kemi qëndruar përkohësisht në këtë banesë dhe, ndërkohë, kemi porositur banesën tonë në qytetin e Tiranës, ku jemi transferuar për banim në momentin që firma ka përfunduar punimet, duke u bërë e jetueshme, nga ana jonë.*

Gjithsesi, në lidhje me faktin nëse kanë pasur burime apo jo prindërit e bashkëshortit për të blerë këtë banesë, nuk mund të arrihet në një përfundim bazuar vetëm me administrimin e të ardhurave të tyre prej pagave, pasi burimi për krijimin e një pasurie të paluajtshme, përveç të ardhurave nga pagat, mund të përfshijë kreditë bankare ashtu edhe marrëdhëniet financiare me persona të tretë apo përdorimi i mjeteve monetare, të familjarëve të tyre, të cilat prindërit e bashkëshortit i kanë disponuar në momentin e transaksionit. Për këtë fakt nuk jam në gjendje të disponoj një pasqyrë të saktë financiare, pasi do të duhej që nga ana e tyre të deklarohej çdo marrëdhënie financiare e tyre me persona të tretë, por nga sa kam mësuar prej tyre, në pagesën e kryer janë përdor edhe shumat monetare në valutën e huaj, dollar, të cilat iu kanë ardhur nga familjarë të tyre të afërt me anë të transfertave bankare.

Referuar ligjit nr. 84/2016 është përcaktuar se objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij³⁶. Sipas përkufizimit ligjor, në kuptim dhe në zbatim të këtij ligji, për termin ‘Pasuri’ janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, ‘Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

Në interpretim literal të këtyre rregullave ligjore, kërkohet dhe ngarkohet me detyrim ligjor subjekti i rivlerësimit të provojë burimin e krijimit të pasurive në pronësi dhe në posedim, në momentin e depozitimit të deklaratës Vetting. Në kohën kur ka hyrë në fuqi ligji me nr. 84/2016, ky apartament, prej shumë vitesh nuk ka qenë në përdorimin tonë”.

Vlerësimi i Komisionit

- Bazuar në të gjitha sa më sipërrasyetuar, në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti arriti të kundërshtojë bindshëm barrën e provës në lidhje me këto dy pasuri.

- Në vlerësimin përfundimtar për këtë pasuri, Komisioni mori në konsideratë çështjen e përfunduar të bashkëshortit të subjektit (subjekt rivlerësimi) me vendimin nr. ***, datë 23.3.2021³⁷ (vendim i formës së prerë).

³⁶Neni 30 i ligjit me nr. 84/2016 “Objekti i vlerësimit të pasurisë”.

³⁷Shihni vendimin nr. ***, datë 23.3.2021, të Komisionit për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

- Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se subjekti ka kryer deklaram të saktë.

7. Në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2006, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar adresën: “Rr. ‘***’, ap.***, p. ***, Nj. Nr. ***, Tiranë”. Pasi i janë kërkuar shpjegime, në lidhje me këtë adresë, në përgjigjet e pyetësorit nr. ***, subjekti ka sqaruar se në këtë adresë të deklaruar në fillim të detyrës, ka qëndruar gjatë muajve tetor - nëntor 2006, gjatë kohës që kërkonte banesë me qira. Më tej, bashkëshorti i subjektit sqaron se kjo banesë i përket prindërve të subjektit dhe është e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në emër të shtetasve z. A.A, babai i subjektit, dhe z. D.A, vëllai i subjektit. Këto pretendime vërtetohen me kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe kontratën e blerjes së saj bashkëngjitur përgjigjes së ZVRPP-së Tiranë³⁸.

8. Në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2006, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar adresën: “Rr. ‘***’, p. ***, Nj. nr. ***, Tiranë”. Në lidhje me këtë adresë, në përgjigjet e pyetësorit nr. ***, ka sqaruar se ka jetuar në këtë banesë në periudhën dhjetor 2006 - gusht 2007, së bashku me vëllain A.Ç, me kontratë qiraje verbale, me pagesë mujore 30,000 lekë. Më tej, bashkëshorti i subjektit deklaroi se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk mban mend emrin apo ndonjë kontakt tjetër të qiradhënësit, por deklaroi me vetëpërgjegjësi se me atë person nuk ka pasur asnjë çështje në shqyrtim dhe, për më tepër, që në atë periudhë ka ushtruar funksionin si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Lushnjë. Pjesa prej ½ e shumës prej 30,000 lekësh është futur si shpenzim në analizën financiare. Në përfundim të hetimit administrativ, referuar periudhës së shkurtër të përdorimit dhe mungesës së informacioneve në lidhje me pronësinë e mundshme të subjektit mbi këtë pasuri, nga Komisioni nuk ka pasur dyshime dhe nuk ka evidentuar problematika.

9. Nga verifikimi i DPV-së për periudhën 2007 – 2016 është konstatuar se si adresë e regjistrimit në gjendjen civile është deklaruar adresa: “Rr. ‘***’, Nj. Nr. *** Tiranë”.

Në lidhje me këtë adresë, në përgjigjet e pyetësorit nr. ***, bashkëshorti i subjektit ka sqaruar se shkak për regjistrimin e kësaj adrese në gjendjen civile, ka qenë pasi ka banuar për dy vite në një banesë në këtë adresë, në vitin 2004, pasi është ndarë nga trangu familjar, deri në vitin 2006, kur ka kryer studimet e magjistraturës, vit që u shkëput nga trangu familjar. Me tej, sqaron se në periudhën 2007 – 2010, kur ka qenë prokuror në Lushnjë, ka banuar pranë prindërve në Lushnjë në banesën e babait I.Ç, për të cilën ka paraqitur kartelë pasurie e në vijim, pas vitit 2010, ka deklaruar si adresë banimi apartamentin e blerë në rrugën “***”, ndërkohë që ka lënë të kuptohet se nuk ishte bërë çregjistrimi i adresës në rrugën “***”, nga aktet e gjendjes civile. Në përfundim të hetimit administrativ, referuar kohës së gjatë e mungesës së të dhënave që lidhin subjektin e rivlerësimit me ndonjë pasuri në këtë adresë, Komisioni nuk ka pasur dyshime dhe nuk ka evidentuar problematika.

10. Në lidhje me një depozitë në vlerën 11,500 USD, çelur në datën 29.6.2001, dhe një depozitë në vlerën 53,000 USD, çelur në vitin 2000, në “Tirana Bank”, të dyja prej subjektit, iu kërkua informacion bankës, e cila ka vënë në dispozicion lëvizjet e llogarive bankare, nga ku rezultoi se:

- në datën 1.1.2000 është çelur një llogari në monedhën dollar amerikan dhe është depozituar shuma 28,000 USD. Në datën 11.9.2000 është depozituar shuma 25,000 USD. Shuma e përfutur prej 53,000 USD është investuar deri më 21.9.2001. Depozita e mësipërme, së bashku me interesat, janë tërhequr nga subjekti Arbena Ahmeti në tri pjesë, deri më 16.10.2001, ku depozita është mbyllur tërësisht;

- në datën 29.6.2001, subjekti ka kryer depozitim *cash* në shumën 11,500 USD. Kjo shumë investohet disa herë në depozitë me afat, në periudhën 3.7.2001 – mars të vitit 2003. Nga data 4.3.2003 nga kjo llogari kryhen vetëm tërheqje dhe balanca e saj deri në fund të vitit 2006 është 1,243.92 USD. Gjatë vitit 2007, kjo depozitë shtohet me depozitime në total prej 2,000 USD (krijuar me burime të ligjshme, pasi analiza financiare për vitin 2007 është pozitive) dhe investohet në

³⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 27.2.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë, në dosjen e Komisionit.

depozita me afat. Së bashku me interesat e përfutuara, shuma prej 3,852 USD tërhiqet në datën 8.9.2008 dhe është paguar në datën 9.9.2008 si pjesë e kësaj prej 18,000 euro për blerjen e pasurisë, nëpërmjet depozitimit në “Raiffeisen Bank”, në të njëjtën datë të nënshkrimit të kontratës së porosisë me nr. *** prot., datë 9.9.2008.

Duke qenë se pjesa prej 1,244 USD vjen nga depozita e subjektit, e krijuar më 29.6.2001, në “Tirana Bank”, u kërkuan sqarime në lidhje me burimin e ligjshëm të kësaj depozite, ashtu sikurse edhe në lidhje me depozitën në vlerën 53,000 USD, çelur prej saj në vitin 2000, e mbyllur më 16.10.2001. Në përgjigjet e datës 24.11.2020, bashkëshorti i subjektit është përgjigjur se depozitat janë krijuar në emër të bashkëshortes në “Tirana Bank”, si fëmija madhor i familjes e me të ardhura të babait të saj si emigrant ekonomik që prej vitit 1990, i cili çdo kursim e ka nisur për nevoja të familjes, por nuk ka vënë në dispozicion dokumente shpresore për të vërtetuar të ardhura ligjore të babait të bashkëshortes.

Nga verifikimi i deklaratës para fillimit të detyrës, datë 3.11.2006, subjekti ka deklaruar si pasuri shumë 1,200 USD, me burim “si rezultat i dhuratës së bërë nga babai”. Por, pavarësisht kësaj, në kushtet kur subjekti nuk ka paraqitur dokumente shpresore për të vërtetuar të ardhura të ligjshme të babait për të krijuar depozitën në vitin 2001, si rrjedhim edhe për të dhuruar shumë 1,200 USD. Duke qenë se kjo shumë është dhuruar para emërimit në detyrë të subjektit, është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të vitit 2007.

6. Analiza financiare

6.1 Komisioni, në përfundim të rezultateve të hetimit, konstatoi se subjekti dhe personi i lidhur, kanë pasur pamundësi financiare nga fillimi i detyrës deri në vitin 2016 në vlerën 1,815,796 lekë.

6.2 Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit lidhur me analizën financiare.

6.3 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi³⁹ se: *“Mendoj që duhet të rishikohet analiza financiare duke u shtuar zëri përkatës dhe duke e quajtur të mjaftueshme analizën financiare totale, pavarësisht se konstatoj se edhe zëra të tjerë mund të rishikohen, por nisur nga rrethana dhe fakti se gjithsecili prej tyre janë në shuma të vogla, nuk mendoj se ka vlerë të ndalem për secilin rast.*

Gjithsesi, në secilin rast alternativ të vlerësimit të analizës financiare, sjell në vëmendje të trupit gjykues, se për pasuritë e vëna gjatë martese, unë jam bashkëpronar në 50% të tërësisë së tyre dhe përgjigjem si subjekt rivlerësimi dhe deklarues, po për këtë raport pronësie mbi to. Për pjesën tjetër, bashkëpronar është bashkëshorti im, i cili ka qenë gjithashtu subjekt rivlerësimi prej KPK-së.

Unë i qëndroj çdo shpjegimi mbi lart të dhënë, për secilin rast kur më është kaluar barra e provës, por në çdo rast, në vlerësim të trupit gjykues, kërkoj që të mbahet në vlerësim edhe zbatimi i parimit të proporcionalitetit, pasi në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, unë si subjekti i rivlerësimit mendoj të kem provuar se kam arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi përmbush kriteret e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se kam kryer deklarime të sakta si në DPV ashtu dhe në deklaratën Vetting, si dhe kam justifikuar me të ardhura të ligjshme pasuritë dhe shpenzimet për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

Në secilin rast alternativ të vlerësimit të analizës financiare, sjell në vëmendje të trupit gjykues se çdo balancë negative që mund të rezultojë, për shkak të vlerave të tyre⁴⁰, si dhe faktit që vjen prej pamundësisë për të siguruar prindërit, dokumentacioni financiar të mbi 15 viteve më parë ose se

³⁹Shihni përgjigjet e subjektit mbi analizën financiare të dërguar në prapësimet mbi rezultatet e hetimit.

⁴⁰Të tilla që janë në marzhet minimale të mundshme, sipas praktikës të mbajtur prej Komisionit dhe të konfirmuar në disa vendimmarrje të Kolegjit.

ato rezultojnë përpara në kohë se ushtrimi i funksionit gjyqësor nuk mund të përbëjë shkak për penalizim”.

6.4 Pas përgjigjeve të subjektit, Komisioni hartoi analizën financiare si më poshtë, në të cilën rezultoi se subjekti ka qenë në pamundësi financiare në shumën 115,753 lekë, për periudhën 2006 – 2016.

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: ARBENA A. AHMETI												
PERSHKRIMI	04.10.06-31.12.06	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	296,404	1,018,232	3,010,010	3,175,555	724,437	-271,339	86,127	2,046	-433,074	175,454	213,890	7,997,744
Apartament 76 m2 - 60,800€ - 2009 - 50%			4,557,753	2,743,400	505,685							7,806,837
Automjet Benz TR***M - 500,000 leke - A. Ç. - 100%		500,000										500,000
Automjet Benz AA***NP - 3,000€ - Arbena Ahmeti - 2016 - 50%											405,810	405,810
Ndryshim ne likuiditet	296,404	518,232	-1,547,742	432,155	218,753	-271,339	86,127	2,046	-433,074	175,454	-191,920	-714,904
DETYRIME	0	0	1,847,738	2,214,162	-584,347	-1,300,566	-698,600	-910,420	-1,060,000	-240,000	0	-732,033
Hua nga nena N. T. - 10,000€ - 2008			1,231,825	-685,850		-414,900		-280,420				-149,345
Hua nga vjehri I. Ç. - 5,000€ - 2008			615,913				-698,600					-82,688
Kredi Alpha Bank 3,000,000 leke - 2009				2,900,012	-584,347	-2,315,666						0
Hua nga vjehri I. Ç. - 1,430,000 leke - 2011						1,430,000		-630,000	-560,000	-240,000		0
Hua dhene nenes N. T. - 500,000 leke - 2014									-500,000			-500,000
												0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	296,404	1,018,232	1,162,273	961,393	1,308,784	1,029,227	784,727	912,466	626,926	415,454	213,890	8,729,776
TE ARDHURA dokumentuar	208,040	2,497,138	1,862,882	1,844,773	2,216,149	1,937,050	1,833,339	2,181,990	2,232,367	2,155,952	2,569,417	21,539,097
Të ardhura nga paga subjekti	208,040	820,564	940,188	833,949	893,456	1,030,922	905,307	895,066	1,017,466	1,034,136	837,791	9,416,885
Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit		776,574	922,694	1,010,824	872,693	906,128	928,032	1,286,924	1,214,901	1,121,816	1,731,626	10,772,212
Te ardhura nga pasurite paramartesore bashkeshorti		900,000										900,000
Te ardhura nga shitja e automjetit Benz - 2010					450,000							450,000
SHPENZIME	27,389	664,496	519,605	690,143	901,339	901,835	855,313	962,998	1,334,747	1,554,431	1,889,801	10,302,098
Shpenzime jetese	27,389	273,240	273,240	387,090	409,860	409,860	418,644	387,816	659,994	672,828	822,822	4,742,783
Shpenzime per interesa dhe komisione kredie Alpha Bank				276,653	250,604	191,780						719,038
Shpenzime shkollimi femijet								88,000	220,000	489,890	514,026	1,311,916
Shpenzim terheqje nga A. C. per shpenz familjare nga Alpha Bank - 27/11/13								160,000				160,000
Shpenzime qiraje		120,000										120,000
Shpenzime transporti A. C. (Lushnje, Berat)		21,000		26,400	39,600	72,000	72,000	72,000	72,000	42,000		417,000
Shpenzime mobilimi		110,000			180,453		83,832					374,285
Shpenzime mjekesore										40,000	484,939	524,939
Shpenzime udhetimi	0	140,256	246,365	0	20,822	228,195	280,837	255,182	382,753	309,713	68,015	1,932,137
Analiza dokumentuar	-115,753	814,410	181,004	193,237	6,026	5,988	193,299	306,526	270,693	186,068	465,726	
									Pamundesia financiare totale			-115,753

6.5 Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: “Raiffeisen Bank”, “Tirana Bank”, BKT-ja, “Intesa Sanpaolo Bank”, “Alpha Bank”, “Abi Bank” si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

- i. të ardhurat nga pagat e subjektit në: Bashkinë Tiranë (viti 2004), Shkollën e Magjistraturës (periudha 2004 – 2009), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (vitet 2006 – 2007), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë (periudha 2007 – 2013), Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (periudha 2013 – 2016), universiteti “A.U” Berat (viti 2011), lejelindje (vitet 2009 dhe 2016);
- ii. të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit në: Shkollën e Magjistraturës (periudha 2004 – 2006), Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë (periudha 2006 – 2009), Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat (periudha 2009 – 2015), Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (viti 2016);
- iii. të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” (viti 2010);
- iv. të ardhurat nga pasuritë paramartesore të bashkëshortit.

Të ardhurat në vlerën 300,000 lekë, të deklaruara me burim nga dhurimi i nënës së subjektit në vitin 2006, nuk janë përfshirë në analizën financiare të këtij viti, pasi nuk vërtetohet burimi i ligjshëm i krijimit të tyre⁴¹.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- i. shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i. Vetëm në vitin 2013, nuk janë vënë shpenzime jetese për muajin dhjetor sepse në datën 27.11.2013, bashkëshorti i subjektit, z. A.Ç, tërheq nga banka vlerën 160,000 lekë për shpenzime familjare. Vlera prej 160,000 lekësh është përfshirë në shpenzimet e vitit 2013;
- ii. shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (J.R.), datë 22.5.2015, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti kanë deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrimi pranë të afërmeve;
- iii. shpenzime mobilimi të deklaruara nga subjekti (vitet 2007, 2010 dhe 2013), të deklaruara prej saj në përgjigje të pyetësorit;
- iv. shpenzime interesash, principali dhe shpenzime të tjera të lidhura me kredinë në “Alpha Bank”;
- v. shpenzim qiraje të deklaruara nga subjekti dhe bashkëshorti në përgjigje pyetësori;
- vi. shpenzime shkollimi për fëmijët (periudha 2013 – 2016) sipas përgjigjeve të subjektit dhe bashkëshortit në përgjigje pyetësori;
- vii. shpenzime mjekësore (periudha 2015 – 2016) sipas përgjigjeve të subjektit dhe bashkëshortit në përgjigje pyetësori. Shpenzimet i referohen ndjekjes së një shtatzënie dhe shpenzimeve të tjera pas lindjes. Shpenzimet e ndjekjes së shtatzënisë janë ndarë në mënyrë përpjesëtimore në periudhën nëntor 2015 – korrik 2016;
- viii. Shpenzime transporti ndërqytetas të bëra nga bashkëshorti i subjektit në qytetet Lushnjë dhe Berat, sipas përgjigjeve të dhëna në pyetësorët e dërguara nga Komisioni.

⁴¹Shihni analizën financiare në pikën 1.21.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/ shitblerjeve të këtyre pasurive⁴².

d. Në vlerat e huave të marra nga nëna e subjektit (viti 2008) dhe babai i bashkëshortit të saj (vitet 2008 dhe 2011), si dhe në vlerat e kredisë së marrë në “Alpha Bank” (viti 2009).

Vlerësimi i Komisionit

6.6 Bazuar në të gjitha sa më sipërsyrtuar, në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti arriti të kundërshtojë bindshëm barrën e provës në lidhje me analizën financiare.

6.7 Komisioni vlerësoi se pamundësia financiare, në vlerën 115,753 lekë për të gjithë periudhën e rivlerësimit, bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

6.8 Në vlerësimin përfundimtar për këtë pasuri, Komisioni mori në konsideratë çështjen e përfunduar të bashkëshortit të subjektit (subjekt rivlerësimi) me vendimin nr. ***, datë 23.3.2021⁴³ (vendim i formës së prerë).

6.9 Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për krijim likuiditetesh, blerje pasurie dhe kryerje shpenzimesh, nga fillimi i detyrës deri në vitin 2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2021, ka dërguar raportin e deklasifikuar me vendimin nr.***, datë 12.7.2021, të KDZH-së, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 13.7.2021 (sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016), nga ku rezulton se:

- Për subjektin e rivlerësimit Arbena Ahmeti nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.
- Konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Arbena Ahmeti.

Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me kriterin e figurës për subjektin e rivlerësimit Arbena Ahmeti.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i vlerësimit profesional është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Raporti i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;

⁴²Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴³Shihni vendimin nr. ***, datë 23.3.2021, të Komisionit për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së.

❖ GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotë sipas shtojcës që përcakton ligji. Formulari nuk ka kundërthënie, nuk ka mangësi dhe është i nënshkruar rregullisht.

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëvlerësimit, subjekti i rivlerësimit, ka qenë: gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (stazhiere) në periudhën tetor 2006 – tetor 2007; gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë në periudhën tetor 2007 – nëntor 2013; dhe gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga nëntori i vitit 2013 dhe aktualisht.

Në rubrikën e të dhënave statistikore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar numrin e çështjeve të caktuara dhe, konkretisht: në harkun kohor janar 2013 - tetor 2013, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje i janë caktuar 205 çështje; për periudhën nëntor 2013 – qershor 2016 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë i janë caktuar 1562 çështje; në qershor të vitit 2016 dhe deri në momentin e dorëzimit të formularit gjyqtarja ka qenë me leje lindje dhe nuk i janë caktuar çështje.

Subjekti ka deklaruar numrin e çështjeve të përfunduara për tri vitet e fundit dhe, konkretisht: për harkun kohor janar 2013 - tetor 2013 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka përfunduar 267 çështje; dhe për periudhën nëntor 2013 – qershor 2016 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka përfunduar 1562 çështje.

Subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, të llojit “vendim gjyqësor”. Të tri vendimet i përkasin vitit 2015.

1. Vendimi nr. *** (***), datë 9.4.2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë, me paditës E.L, i paditur Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Komisioni i Apelit të Masave Disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme, me objekt “shfuqizimi i akteve administrative nr. ***, datë 9.1.2015 dhe nr. ***, datë 4.2.2015, nr. *** prot., datë 6.12.2013”.
2. Vendimi nr. *** (***), datë 12.11.2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë, me paditës shoqëria tregtare “****” sh.a., i paditur Qendra Kombëtare e Punësimit, personi i tretë shoqëria tregtare “****” sh.a., me objekt “anulimi tërësisht i aktit administrativ, etj.”.
3. Vendimi nr. ***(***), datë 25.5.2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë, me paditës shoqëria “****”, sh.a., i paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “detyrimi i palës së paditur të marrë në shqyrtim kërkesën për t’u rikthyer në detyrën e gjyqtarit në respekt të statusit të paditësit dhe detyrimin për pagimin e pagës së gjyqtarit nga data 21.2.2009 deri në fillim të detyrës”.

❖ PËRSHKRIMI I PESË DOSJEVE GJYQËSORE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Dosja 1. Çështja administrative nr. ***(***) regjistri, datë 16.7.2015 regjistrimi, që i përket paditësit, shoqëria “****” sh.a., kundër të paditurit, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria e Apelit Tatimor, DPT Tiranë, me objekt “shpalljen relativisht të pavlefshëm të njoftimit të vlerësimit tatimor, etj., anulimin e vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor, nr. ***, datë 26.6.2015”, e përfunduar me vendimin nr. *** datë 29.9.2015.

Veprimi përgatitor, datë 27.7.2015 (brenda 7 ditëve), është kryer në dhomë këshillimi dhe pa praninë e palëve.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 2 muaj e 9 ditë, në intervalin kohor 20. 7.2015 – 29.9.2015. Kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar me 1 muaj e 9 ditë afatin standard 1-mujor të përcaktuar nga germa “c” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Në këtë afat përfshihet edhe leja vjetore e muajit gusht. Gjyqtarja ka zhvilluar një veprim përgatitor sipas procedurës dhe afateve të parashikuara në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012. Në vijim, janë caktuar dhe zhvilluar 2 seanca gjyqësore, të cilat kanë qenë të gjitha produktive.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës ditën e shpalljes së vendimit, duke respektuar afatin 7-ditor të përcaktuar nga pika 3 e neni 42, të ligjit nr. 49/2012.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 29.9.2015 përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Rezulton se paditësi ka paraqitur ankim, ku me vendimin nr. ***, datë 28.3.2019, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 29.9.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Dosja 2. Çështja administrative nr. *** regjistri, datë 19.12.2013 regjistrimi, që i përket paditësit Fatos Vila kundër të paditurit Dega e Doganës Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë, me objekt “anulimin e aktit administrativ”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.2.2014.

Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe me shortin elektronik të datës 20.12.2013 i është caktuar subjektit të rivlerësimit, gjyqtarës Arbena Ahmeti.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 2 muaj e 1 ditë. Kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar me 1 muaj e 1 ditë afatin standard 1-mujor, të përcaktuar nga germa “c” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës në datën 27.2.2014, 6 ditë nga shpallja e vendimit, duke respektuar afatin 7-ditor të përcaktuar nga pika 3 e neni 42, të ligjit nr. 49/2012.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 21.2.2014, përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Paditësi ka paraqitur ankim, ku Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 20.3.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 21.2.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Dosja 3. Çështja administrative nr. *** regjistri, datë 3.10.2014 regjistrimi, që i përket paditësve E.V dhe D.V kundër të paditurit Zyra e Gjendjes Civile Komuna F, me objekt “ndryshimi i akteve të gjendjes civile në rubrikën emri, detyrimi i palës së paditur të bëjë ndryshimet”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 10.2.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe me shortin elektronik të datës 7.10.2014 i është caktuar subjektit të rivlerësimit, gjyqtarës Arbena Ahmeti.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës, duke respektuar afatin 7-ditor të përcaktuar nga pika 3 e neni 42, të ligjit nr. 49/2012.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 4 muaj e 3 ditë. Kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar me 3 muaj e 3 ditë afatin standard 1-mujor të përcaktuar nga germa “c” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 10.2.2015, përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Nga aktet e paraqitura nuk evidentohet nëse palët kanë paraqitur ankim kundër vendimit gjyqësor.

Dosja 4. Çështja administrative nr. *** regjistri, datë 4.4.2014 regjistrimi, që i përket paditëses D.D kundër të paditurit Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me objekt “kundërshtim vendimi, detyrimi për rillogaritje pensioni dhe detyrimi për dhënien e diferencave”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.9.2014.

Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe me shortin elektronik të datës 7.4.2014 i është caktuar subjektit të rivlerësimit, gjyqtarës Arbena Ahmeti.

Rezulton se vendimi është dorëzuar i arsyetuar nga gjyqtarja, duke respektuar afatin 7-ditor të përcaktuar nga pika 3 e neni 42, të ligjit nr. 49/2012.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 5 muaj e 15 ditë. Kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar me 4 muaj e 15 ditë afatin standard 1-mujor të përcaktuar nga germa “c” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 22.9.2014, përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Ky vendim është i paankimueshëm, në bazë të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012.

Dosja 5. Çështja administrative nr. *** regjistri, datë 10.9.2015 regjistrimi, që i përket paditëses D.T kundër të paditurit Prefektura e Qarkut Dibër, me objekt “detyrim nga marrëdhëniet e punës”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 20.10.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe me shortin elektronik të datës 11.9.2015 i është caktuar subjektit të rivlerësimit, gjyqtarës Arbena Ahmeti.

Planifikimi i seancës është për një afat 5-ditor, brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 302 i Kodit të Procedurës Civile.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës, duke respektuar afatin 7-ditor të përcaktuar nga pika 3 e neni 42, të ligjit nr. 49/2012.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 1 muaj e 9 ditë. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 20.10.2015, përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Pala e paditur ka paraqitur ankim kundër vendimit gjyqësor.

Me vendimin, datë 13.11.2015, është disponuar për pranimin e ankimit ndaj vendimit nr. ***, datë 20.10.2015, një kopje e të cilit ndodhet në fashikullin gjyqësor nr. ***, datë 10.9.2015.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 22.2.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 20.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë së paditëses D. T. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditëses, me arsyetimin se: *“Marrëdhënia e punës mes palëve ndërgjyqëse nuk rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës, për sa kohë pozicioni i punës së paditëses është vlerësuar pozicion politik, në kuptim të nenit 14/2 të ligjit nr. 8095, datë 21.3.1996, ‘Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë’”*.

Ndaj vendimit është ushtruar rekurs dhe sipas printimit nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, çështja është ende në pritje për t’u gjykuar.

Për gjetjet e konstatuara lidhur me 5 çështjet e shortuara, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: *“Vlerësimi profesional i gjyqtarit, në bazë të akteve normative dhe akteve nënligjore, në raport me kriterin ‘kohëzgjatja e gjykimit’ bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor, me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat. Në detyrën e vlerësuesit është bërja e analizës së të dhënave statistikore në mënyrë të tillë që të shmangen përfundime që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat e burimeve të tjera të vlerësimit.*

Gjykimi administrativ është një gjykim i një natyre komplekse dhe shpeshherë i vështirë për t’u kryer brenda afateve të shpejta, të tilla si një muaj, pasi sjellja e organeve publike, që janë të ngarkuar me barrën e provës në këtë gjykim, në të shumtën e rasteve, nuk është në përputhje me detyrimet ligjore, sipas germës ‘b’ të nenit 25 dhe nenit 26, në referencë zbatimi neni 35 të LGJA⁴⁴-së, pavarësisht masave të marra prej meje si gjyqtare, në zbatim të ligjit për të realizuar gjykimin e shpejtë.

Organet publike shpesh pësojnë ndryshime strukturore dhe funksionale, që passjell vonesa në gjykim, pasi vjen për pasojë kryerja e veprimit procedural të kalimit procedural, ndryshimi i përfaqësuesve ligjorë apo urdhërimi kryesisht të paraqitjes së akteve shkresore apo provave, etj. Shpeshherë organet publike nuk paraqesin prova apo informacionin e nevojshëm për gjykatën apo e lënë gjykimin në mungesë, ndaj në mënyrë që të arrihet balanca e duhur midis detyrimit për të kryer një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm, në mbrojtje të interesit publik dhe detyrimit për gjykimin brenda afateve të shpejta, veprohet me marrjen e tyre kryesisht, për këtë shkak ndodh shtyrja e gjykimit, etj.

LGJA-ja nuk përcakton afat për gjykimin administrativ në shkallë të parë, afat minimal, maksimal apo marzh afati, brenda të cilit duhet të përfundohet gjykimi. Rregulli ligjor që përcakton që duhej të përfundonte gjykimi brenda 30 ditëve për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të LGJA-së.

Gjithashtu, përdor si busull orientuese edhe afatet e përcaktuara në dispozitat ligjore të neneve 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, meqenëse vetë LGJA-ja referon në këtë Kod për çështje që nuk janë rregulluar në të. Dispozita ligjore e germës ‘a’, të pikës 1, të nenit 399/2, të Kodit të Procedurës Civile, në fuqi dhe e zbatueshme, që përcakton se afati 1 vit është afat i arsyeshëm për kohën e gjykimit administrativ në shkallë të parë.

⁴⁴Përmendet si anakronim i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar.

*Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, në vitin 2012, me nenin 72 i tij, është shfuqizuar neni 327 i Kodit të Procedurës Civile, i cili ishte në fuqi në vitin 2010, ku është përcaktuar prej akteve nënligjore afati 30-ditor për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative, si standard minimal. Standardi minimal kohor 1-mujor është përcaktuar në vendimin nr. ***, datë 14.4.2010⁴⁵, të KLD-së.*

Afatin standard minimal prej 30 ditësh si kohëzgjatje të gjykimit, arrij ta realizoj në një kategori gjykimesh të thjeshta, që lidhen me kundërvajtjet administrative në fushën e rregullave të qarkullimit rrugor, mosmarrëveshje administrative, për të cilat ndjek dhe zhvilloj gjykimin mbi aktet shkresore, që lidhen, më së shumti, me masa disiplinore të nëpunësve civilë, etj.

Gjykimi administrativ është një gjykim i një natyre komplekse dhe shpeshherë i vështirë për t'u kryer brenda afateve të shpejta. Afati 30 ditë është një afat i pamundur për pjesën më të madhe të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve administrative, në mënyrë objektive, edhe për disa arsye si:

Ngarkesa e lartë në punë.

Legjislacioni në fushën e së drejtës publike është shumë i larmishëm, i detajuar me akte nënligjore, në përditësim të përhershëm dhe shpesh praktikat administrative janë jo të njëjta të ndjekura prej organeve publike gjatë procedurave administrative. Kjo situatë kërkon kohën e nevojshme, që për çdo çështje të studiohen aktet e paraqitura, baza ligjore, pretendimet e palëve, në mënyrë të detajuar.

Infrastruktura mbështetëse në burimeve njerëzore, që mbështetin veprimtarinë time si gjyqtare, sekretaria gjyqësore dhe ndihmësit ligjorë, mendoj se kanë qenë në nivele të aftësive nën mesatare, pra jo në nivelin që duhet të kenë për të asistuar dhe ndihmuar në mënyrë objektive.

Mjetet e infrastrukturës teknike, gjithashtu ndikojnë. Aktualisht, unë si gjyqtare nuk kam një zyrë ku të studioj aktet, legjislacionin dhe të shkruaj vendimet e qetë, pasi në zyrë punon së bashku me mua edhe sekretaria gjyqësore, e cila duhet të merret me veprimet procedurale dhe me palët njëherësh, për njoftim të akteve, etj. Kjo vështirëson tej mase punën time që ta zhvillojë në mënyrë të qetë, pavarësisht përkushtimit të madh.

Zhvillimi i një numri shumë të madh dhe kompleks të veprimeve procedurale dhe ndjekja që këto veprimeve të pasqyrohen saktë dhe në përputhje me ligjin procedural prej sekretarisë gjyqësore”.

Vlerësimi i Komisionit

Pas dhënies të shpjegimeve⁴⁶, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm dhe kundërshtoi konstatimet e bëra lidhur me gjetjet mbi 5 çështjet gjyqësore të shortuara.

❖ TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Arbena Ahmeti janë paraqitur gjithsej 8 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (1 ankesë në vitin 2013, 3 ankesa në vitin 2014, 2 ankesa në vitin 2015 dhe 2 ankesa në vitin 2016).

Tri ankesa (2 të vitit 2014 dhe 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

⁴⁵Në pikën 5, germa “c” e “Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore”, miratuar me vendimin nr. 261/2, të vitit 2010, të KLD-së, lidhur me standardin minimal kohor për gjykimin e çështjeve administrative, parashikohet se: “Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes, si më poshtë: “...c. Gjykimet e mosmarrëveshje administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo me tej se 1 muaj”.

⁴⁶Shihni përgjigjet e subjektit në prapësimet e paraqitura mbi rezultatet e hetimit.

Pesë ankesa të tjera janë verifikuar dhe rezultatet e tyre janë, si vijon:

- i. 1 ankesë e vitit 2013, verifikuar për mosrespektim formal ligji është arkivuar pasi pretendimet janë të pabazuara;
- ii. 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar bazuar mbi informacionin e kryetarit për vendimet e cenuara, i është regjistruar gjyqtares për vlerësim profesional dhe etik;
- iii. 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për shkelje etike është arkivuar, pasi pretendimet janë të pabazuara.
- iv. 1 ankesë e vitit 2015 verifikuar për zvarritje gjykimi i është regjistruar gjyqtares për vlerësim profesional dhe etik;
- v. 1 ankesë e vitit 2016 është në proces verifikimi për zvarritje gjykimi. Kjo ankesë sipas informacionit të marrë me email nga specialistja përkatëse, rezulton se për të ka përfunduar verifikimi për zvarritje gjykimi dhe i është regjistruar gjyqtares për vlerësim etik dhe profesional.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Arbena Ahmeti, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Për gjetjet e konstatuara lidhur me 2 ankesat e regjistruara për vlerësim etik dhe profesional, subjektit iu kërkua të japë shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se: *“Sipas të dhënave janë tri ankesa të regjistruar për vlerësim etik dhe profesional. Në raportin e trupës gjyquese, por edhe në raportin profesional që KLGJ-ja ka përgatitur për efekt të procesit të rivlerësimit në lidhje me mua si gjyqtare dhe si u njoha me materialet e hetimit administrativ, dorëzimi i CD-së në datën 13.10.2021 nuk ka të dhëna të indentifikueshme për këto ankesa, që unë të kem mundësinë të jepja shpjegime rreth tyre.*

*Në tilla rrethana iu drejtova me kërkesë, në rrugë elektronike me anë të e-mail-it në datën 14.10.2021, KLGJ-së, si autoriteti përgjegjës që administron këto të dhëna (bashkëngjitur, Ju lutem gjeni printim të e-mail-it datë 14.10.2021, drejtuar KLGJ-së). Prej KLGJ-së, në datën 18.10.2021, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 18.10.2021, m'u vunë në dispozicion të dhëna.*

*Këto të dhëna po i vë në dispozicion të trupës gjyquese për vlerësim, pasi në to gjenden të dokumentuara çdo veprim procedural i kryer prej meje si gjyqtare, si dhe shpjegime të dhëna nga unë në kohën e verifikimit të ankesës prej inspektorëve të ish-KLD-së. Duke qenë se kam të njëjtin qëndrim, po jua përcjell në tërësi aktet. Për efekt të shpjegime më duhet të vërej se vendimet e cenuara prej gjykatave më të larta nuk janë kriter vlerësues dhe përcaktues për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, me sistemin e ri të vlerësimit. Megjithatë, prej ILD-së është vendos arkivimi i këtyre informacioneve, në raste të ngjashme dhe për periudhën kohore të njëjtë. Po ju vë në dispozicion shkresën me nr. *** prot., datë 19.4.2021.*

Gjithashtu, sjell në vëmendje se një nga tri ankesat i përket shtetasit A.Q, i cili ka bërë edhe denoncim ndaj meje. Ndërsa vendimi që unë kam dhënë si gjyqtare në gjykimin e kësaj çështjeje është i formës së prerë, duke u vendos mospranim ankimi”.

Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me dy ankesat e regjistruara për vlerësim etik dhe profesional për subjektin e rivlerësimit.

ANALIZA E GJETJEVE

Subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti është magjistrate e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës. Ajo ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ajo kualifikon drejt marrëdhënien juridike, objekt shqyrtimi gjyqësor, duke orientuar gjykimin dhe arsyetimin në këtë drejtim (shihni 3 dokumentet dhe 5 dosjet). Ajo njih dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit, siç janë parimi se barra e provës për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ, objekt shqyrtimi gjyqësor, i takon organit të administratës publike. Ajo përdor edhe ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre (shihni 3 dokumentet dhe 5 dosjet). Gjyqtarja, kur është rasti, referon normat kushtetuese në praktikën e Gjykatës së Lartë, si dhe në KEDNJ dhe Kartën Europiane mbi Statusin për Gjyqtarët.

Subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme.

Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Arbena Ahmeti ka qenë në intervale kohore nga 1 muaj dhe 9 ditë deri në 5 muaj e 15 ditë. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 5 muaj e 15 ditë ka qenë çështje administrative me objekt kundërshtim vendimi.

Në analizë të të dhënave, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti ka pasur ngarkesë tepër të lartë sasiore dhe në përgjithësi e respekton kohën në gjykim si një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor.

Subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore.

DENONCIMET

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 19 denoncime, si vijon:

1. Denoncim nr. *** prot., datë 29.12.2017, i shtetasit P.C. Ky shtetas ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shkelje të etikës dhe zvarritje të procesit gjyqësor. Ai citon vendimin gjyqësor nr. ***, datë 18.9.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ky vendim, sipas denoncuesit, është arsyetuar dhe dorëzuar në shkelje të afateve të përcaktuara nga ligji, nuk ka zhvilluar asnjë seancë gjyqësore në sallë audio dhe mungojnë provat audio në dosje. Në lidhje me këto *indicie* të sjella nga denoncuesi, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 18.6.2021, kërkoi dosjen gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila u vu në dispozicion me shkresën nr. *** prot., datë 22.6.2021. Nga studimi i vendimit nr. ***, datë 18.9.2015, u konstatua se gjyqtarja është shprehur me vendim në lidhje me kërkimet e paditësit/denoncuesit P.C dhe ka vendosur rrëzimin e pretendimeve të tij si të pabazuara. Ndërkohë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 28.6.2017, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 18.9.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë. Ndaj këtij vendimi pala paditëse/denoncuesi konstatohet se ka ushtruar të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë.

Nga Komisioni nuk u vlerësua që të bëhen hetime të mëtejshme për këtë denoncim.

2. Denoncimet nr. *** prot., datë 16.3.2018, nr. *** prot., datë 16.3.2018 dhe nr. *** prot., datë 16.3.2018, të shtetasit A.Q. Ky shtetas ka denoncuar disa subjekte, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, për shkelje të etikës profesionale, proces jo të rregullt ligjor dhe mungesë aftësish profesionale. Ndërkohë, për subjektin e rivlerësimit ka paraqitur edhe kallëzim penal në Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këto kushte, nuk rezultuan shkaqe për të hetuar më tej për subjektin e rivlerësimit.

3. Denoncim i shtetas S.J, bashkëshortja e z. O.J. Ky i fundit është një prej trashëgimtarëve të V.F (T). Shtetasja S.J ankohet për shumë subjekte të drejtësisë, ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit, për shkelje të rënda të gjyqësorit e së fundmi edhe nga gjyqtarja Arbena Ahmeti. Kjo shtetase denoncon se: *“Kalvari i gjyqeve ka filluar që nga viti 1998, vit kur prona u zaptua nga persona të tjerë të cilët, pavarësisht proceseve gjyqësore të panumërta, vazhdojnë ta gëzojnë pronën që na është njohur me vendim të KKKP-së së vitit 1996 dhe hipotekuar në janar të vitit 1998. Së fundmi, në vitin 2018, pasi zaptuesit janë bërë pronarë të ndërtimeve të tyre nga ALUIZNI, ne i jemi drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesën për t’u informuar. Gjyqtarja e caktuar me short Arbena Ahmeti, në një hark kohor prej 3 muajsh, cakton 4 seanca përgatitore, të cilat pothuajse i shtyu pa asnjë arsye ligjore dhe me nga 20 ditë distancë kohore nga njëra-tjetra. Dhe në të vetmen seancë të zhvilluar me keqdashje dhe qëllim vendosi të kthejë aktet bashkëlidhur me arsyen se prokura e lëshuar nga ana jonë në favor të përfaqësuesve ligjorë ishte e pasaktë. I ndjeri O.J është një prej trashëgimtarëve të V.F (T). S.J (bashkëshortja) dhe G.J (i biri) kanë caktuar përfaqësues ligjorë A.J (i biri i O.J). Ky i fundit ka zgjedhur të përfaqësohet nga studio ligjore ‘A.H’. Pas shqyrtimit të akteve të përfaqësimit në seancë përgatitore, gjyqtarja Arbena Ahmetaj ka lënë detyrë plotësimin e tri të metave të padisë së paraqitur. Në seancat në vijim pala paditëse ka plotësuar një nga tri detyrat (kërkesat) e lëna dhe, për pasojë, gjyqtarja, referuar nenit 25 të ligjit nr. 49/2012, ‘Për gjykata administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, i ndryshuar, ka kthyer aktet e padisë. Brenda afatit të apelimit pala paditëse e ka apeluar vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit. Çështja pritet të gjykohej”.*

Nuk janë konstatuar problematika për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë është çështje vendimmarrjeje nga një gjykatë më e lartë.

4. Denoncim nr. *** prot., datë 11.9.2018, i shtetasit F.O. Ky shtetas ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për dhënie vendimi të kundërligjshëm në lidhje me prishjen e një pjese të banesës së tij. Pasi është shprehur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjykata Administrative e Apelit e ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Kjo rezultoi një çështje vendimmarrjeje e subjektit dhe jo çështje që të ketë *indicie* për hetime të mëtejshme nga Komisioni.

5. Denoncim nr. *** prot., datë 27.12.2018, i shtetasit T.S. Ky shtetas ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shkelje ligjore në dhënien e vendimit nr. ***, datë 9.9.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Bashkëlidhur ka paraqitur: vendimin nr. ***, datë 9.9.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; kallëzimin penal të T.S ndaj B.; ankimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë kundër vendimeve: nr. ***, datë 9.9.2013 dhe nr. ***, datë 10.6.2019, të subjektit të rivlerësimit; kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Lushnjë për caktimin e masës ndaluese “ndalim i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste”; deklaratën e Prokurorisë së Rrethit Lushnjë për heqje dorë nga ankimi; vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë; kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Lushnjë për gjykimin e çështjes; aktekspertimin kontabël; si dhe shtesë aktekspertimin dhe aktekspertimin kontabël. Siç konstatohet nga studimi i dosjes, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarës së çështjes, me vendimin nr. ***, datë 9.9.2013, ka deklaruar të pafajshëm personin që denoncuesi ka kallëzuar për “shpërdorim të kompetencave” të shoqërisë “***” sh.p.k.

Nga studimi i dosjes rezulton se Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin e sipërcituar. Kjo çështje ka të bëjë me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni.

6. Denoncim nr. *** prot., datë 9.5.2019, i shtetasit E.D. Ky shtetas ka paraqitur denoncimin e tij në formën e kopjes së kallëzimit penal ndaj gjyqtarës Arbena Ahmeti, të cilin e ka paraqitur para organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për dijeni Prokurorisë së Përgjithshme.

7. Denoncim nr. *** prot., datë 29.7.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, i cili denoncon gjyqtaren Arbena Ahmeti se *ka mbajtur qëndrim të hapur në favor të palës paditëse; ka bërë gjykim të padrejtë; se me veprimet e saj arrogante dhe prepotente gjatë seancave ajo nuk e ka lejuar palën e paditur të vijojë mbrojtjen, duke e kërcënuar hapur për vënien e gjobave për përfaqësuesen ligjore të institucionit; ka bërë zbardhjen e vendimit me 2 muaj vonesë, në shkelje flagrante të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.*

Nga praktika e sjellë nga denoncuesi, si dhe nga hetimi i Komisionit, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështjen me palë paditëse shoqërinë tregtare “****” sh.p.k. dhe palë e paditur Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, ku me vendimin nr. ***, datë 2.5.2019, ka vendosur “Pranimin e padisë dhe shfuqizimin e veprimit administrativ, njoftimin nr. *** prot., datë 5.11.2018, për anulimin e procedurës së prokurimit publik të palës së paditur... etj.”. Ndërkohë, pala e paditur Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në datën 15.2.2019 ka paraqitur ankim paraprak me qëllim zënje afati për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar. Në datën 24.6.2019 Shërbimi Gjeologjik Shqiptar i paraqet kërkesë gjyqtare Arbena Ahmeti për zbardhjen e vendimit. Në datën 2.7.2019 Shërbimi Gjeologjik Shqiptar njoftohet me vendimin e arsyetuar dhe në datën 15.7.2019 paraqet ankimin e plotë sipas vendimit të arsyetuar. Ndërsa vendimi për mospranim të ankimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar kundër shoqërisë “****” sh.p.k., i datës 28.6.2019, ka të bëjë me faktin se pas ndryshimeve ligjore të Kodit të Procedurës Civile të vitit 2017, në lidhje me procedurën e depozitimit të ankimit, që do të thotë se, sipas këtyre ndryshimeve, në nenin 444 citohet se: “*Afatet e caktuara në nenin 443 janë të prera dhe fillojnë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar*”. Ndodhur në këto kushte, me të drejtë gjyqtarja nuk ka pranuar ankimin, i cili rezultojnë të jetë paraqitur jo në formën e kërkuar nga ligji procedural civil. Por, konstatohet se subjekti e ka arsyetuar vendimin e datës 2.5.2019 me 2 muaj vonesë, kjo në shkelje të afateve procedurale të caktuara nga neni 42 i ligjit 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Ndërsa ankimin e plotë pala e paditur e ka depozituar pas njoftimit me vendimin e arsyetuar zyrtarisht.

Lidhur me këtë denoncim subjekti ka dhënë shpjegime në prapësimet e paraqitura mbi rezultatet e hetimit.

8. Denoncim nr. *** prot., datë 23.9.2019, të av. S.G dhe av. A.Sh, përfaqësues të rastit të ndërtimit të H. S & Z, të cilët denoncojnë gjyqtaren Arbena Ahmeti *për qëndrim të njëanshëm, duke lejuar avokatët e palës së paditur të diskutonin pa argumente e duke mos lejuar palën paditëse për sqarimet përkatëse; për fshehje provash, duke mos i marrë parasysh ato gjatë procesit, etj.*

Pavarësisht opinioneve e ankesave të denoncuesve, Komisioni nuk gjeti *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit.

9. Denoncim nr. *** prot., datë 21.10.2019, i shtetasit M.Gj. Ky shtetas ka denoncuar shumë subjekte të drejtësisë, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, për veprime korruptive e dhënie vendimesh të padrejta. Për sa kohë është çështje vendimmarrjeje, nuk rezultojnë problematika lidhur me shkelje të subjektit të rivlerësimit.

10. Denoncim nr. *** prot., datë 2.7.2020, i shtetasit V.K, i cili kërkon marrjen e masave në lidhje me paligjshmërinë e veprimeve të gjyqtare Arbena Ahmeti në çështjen civile nr. *** vendimi, i datës 27.5.2019. Siç shihet nga studimi i dosjes kemi të bëjmë me çështje vendimmarrjeje të subjektit të rivlerësimit dhe në këto kushte nuk mund të bëhen hetime të mëtejshme.

11. Denoncim nr. *** prot., datë 9.7.2020, nga një grup juristësh për shumë subjekte të drejtësisë, ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit Arbena Ahmeti, ku denoncojnë sjelljen etike të saj të papërshtatshme për një gjyqtare, si dhe e denoncojnë për veprime korruptive përgjatë ushtrimit të

funksionit të saj si gjyqtare. Nga ana e Komisionit nuk u vlerësua të bëhen hetime të mëtejshme për këtë denoncim.

12. Denoncim nr. *** prot., datë 10.12.2020, nga shtetasi K.G, i cili denoncon gjyqtaren Arbena Ahmeti për shkelje të hapur të ligjit dhe cenimin e të drejtave të tij për një proces të rregullt ligjor lidhur me çështjen ku denoncuesi K.G, në cilësinë e paditësit, ka paditur Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Ministrin e Mbrojtjes dhe Shefin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe person të tretë Presidentin e Republikës së Shqipërisë, me objekt “shfuqizimin e urdhrin të Kryeministrit nr. ***, datë 6.10.2014, ‘Për nxjerrje ne rezervë’ dhe të veprimit tjetër administrativ të të paditurve në fazën e propozimit të urdhrin dhe në fazën e ekzekutimit të tij, etj”. Gjyqtarja, pas shqyrtimit të çështjes, ka shpallur vendimin në datën 28.7.2015. Në datën 11.8.2015 paditësi K.G ka apeluar këtë vendim duke e paraqitur në formën e një apeli (zënie afati) për shkak të mosarsyetimit të vendimit të plotë, por vetëm të dispozitivit të tij ditën e shpalljes. Ndërkohë, pas 1 viti e 4 muaj, në datën 1.12.2016, shtetasi K.G njoftohet zyrtarisht nga gjykata me vendimin e arsyetuar plotësisht. Në datën 2.12.2016 ky shtetas ka depozituar apelin e plotë (sipas vendimit të arsyetuar), në vijim të apelit (zënie afati) të datës 11.8.2015.

Komisioni, pas studimit dhe hetimit të pretendimeve që parashtron denoncuesi, si dhe duke iu referuar akteve ligjore të vëna në dispozicion bashkëlidhur këtij denoncimi të paraqitur para Komisionit, i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit se përse vendimi nr. ***, datë 28.7.2015, është arsyetuar dhe njoftuar paditësit me shumë vonesë.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: *“Referuar të dhënave që kam konsultuar pranë kryesekretarisë së Gjykatës Administrative Tiranë, për të dhënë shpjegime në lidhje me pyetjen e trupës gjyqësore, rezulton se padia administrative e denoncuesit, z. G, është regjistruar në datën 25.5.2015 dhe vendimi përfundimtar për padinë administrative është shpallur në datën 28.7.2015 (ditë e martë). Padia është gjykuar për një kohë prej 2 muaj e 3 ditë, ku pavarësisht kompleksitetit të çështjes, gjatë këtij segmenti kohor janë zhvilluar 6 seanca (veprime procedurale). Dosja gjyqësore është depozituar në Kryesekretarinë e Gjykatës prej sekretares gjyqësore të atashuar prej meje në datën 7.9.2015 (ditë e hënë). Kam verifikuar të dhënat në e-mail, ku rezulton se në datën 4.9.2015 (ditë e premte) kam dërguar në rrugë elektronike, me anë të e-mail-it, sekretarisë gjyqësore të atashuar pranë meje, vendimin e arsyetuar. Pasi, si praktikë pune, çdo vendim të arsyetuar e nis menjëherë me e-mail sekretarisë, që të ketë mundësinë që të bëjë sa më shpejt gati për dorëzim në Kryesekretari dosjen gjyqësore.*

Në muajin gusht gjykata, sipas ligjit, zhvillon pushimet vjetore dhe nuk ofrohet shërbim sekretarie për depozitim dhe dorëzim të dosjeve prej sekretares gjyqësore, pasi edhe këto struktura administrative marrin pushimet vjetore.

Kështu që, me kthimin në punë në muajin shtator, pas pushimeve vjetore, është bërë edhe depozitimi i dosjes në sekretari brenda 7 ditëve pune. Afatet për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, referuar akteve nënligjore të KLGJ-së, llogariten gjithnjë në ditë pune.

Vendimi gjyqësor i arsyetuar sipas ligjit ju njoftohet palëve prej sekretarisë gjyqësore, si funksion administrativ në menaxhimin dhe administrimin e dosjeve gjyqësore dhe gjyqtari nuk zhvillon asnjë funksion mbikëqyrës, kontrollues apo rregullues. Kërkova informacion në lidhje me rastin konkret pranë sekretarisë, për pyetjen që shtron trupa gjyqësore dhe prej tyre m'u vendos në dispozicion vërtetimi që mban informacion përkatës.

*Vendimi nr. ***, datë 28.7.2015, i Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Tiranë është ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 15.4.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin e shpallur prej meje si gjyqtare, mbështetur mbi një vendim të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka shfuqizuar si antikushtetuese disa norma të ligjit nr. 64/2015, kohë pasi është shpallur vendimi prej meje si gjyqtare e shkallës së parë. Këtë rrethanë Gjykata*

Administrative e Apelit e ka qartësuar në përmbajtjen e pjesës arsytuese të vendimit të saj. Është ushtruar rekurs prej palëve ndërgjyqëse në Gjykatën e Lartë dhe dosja gjyqësore ndodhet për njoftim të rekurseve pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe do të niset menjëherë për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

*Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dërguar në datën 23.7.2021 për kompetencë funksionale kërkesa administrative me palë kërkuese përmbaruesi gjyqësor privat Sh.S, me objekt kërkimi 'marrjen e masave ndaj palëve debitore për mos ekzekutim vendimi gjyqësor, në referim të nenit 65 e vijues të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar', në zbatim të vendimit nr. ***, datë 15.7.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit.*

Për shkak të ligjit, neni 65 e vijues i LGJA-së (ligji nr. 49/2012, i ndryshuar) këtë kërkesë e kam në shqyrtim dhe mbi bazën e akteve shkresore për shqyrtimin e saj kam ardhur në dijeni për të dhënat e përmendura më lart, pasi dosja gjyqësore aktualisht ndodhet për shqyrtim rekursi në Gjykatën e Lartë.

Gjithashtu, ju bëj me dije se procesi gjyqësor për padinë administrative të denoncues, z. G është monitoruar edhe prej Inspektoratit pranë KLD-së, për shkak të kontrollit tematik pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, përgjatë vitit 2015. Monitorimi është kryer prej inspektor Q.Z, i cili ka ndjekur çdo seancë përgatitore dhe gjyqësore për këtë çështje gjyqësore. Në përfundim të monitorimit dhe raportit përkatës që ka përgatitur Inspektorati pranë KLD-së, në periudhën kohore përkatëse nuk është reflektuar asnjë gjetje, konstatim apo sugjerim për mua si gjyqtare për gjykimin e kësaj çështjeje dhe nuk më është njoftuar asnjë pretendim i tillë.

Këtë raport unë nuk e disponoj, nuk e di nëse gjendet pranë KLGJ-së apo pranë ILD-së, për shkak të ndryshimeve strukturore administrative, si rezultat i reformimit të këtyre dy institucioneve, por me përgjegjësi të lartë etiko-morale deklaroj, si më lart”.

Pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë çështje.

13. Denoncim nr. *** prot., datë 7.2.2020, i shtetasit I.Z, për subjektin e rivlerësimit Arbena Ahmetin, sipas formularit të denoncimit, por që në tekstin e denoncimit nuk rezulton të përmendet emri i subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, nuk ka *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit.

14. Denoncim nr. *** prot., datë 19.5.2020, i av. B.R, i cili denoncon subjektin e rivlerësimit si të paaftë në dhënien e drejtësisë dhe bashkëlidhur denoncimit të tij paraqet edhe vendimin nr. ***, datë 30.7.2018. Për sa kohë është çështje vendimmarrjeje, nuk u vlerësua të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

15. Denoncim nr.*** prot., datë 8.2.2021, i shtetasit N.T, i cili denoncon mbi paaftësinë dhe shkelje të detyrës së gjyqtares Arbena Ahmeti në dhënien e vendimit nr. ***, datë 12.10.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Nuk rezultojnë *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit.

16. Denoncim nr. *** prot., datë 30.3.2021, i shtetasit A.K, i cili denoncon gjyqtaren Arbena Ahmeti për njëanshmëri në gjykim, shkelje të procesit të rregullt ligjor dhe procesit gjyqësor. Nga studimi i dosjes dhe analizimi i vendimit duket se nuk ka *indicie* për hetime të mëtejshme ndaj subjektit, pasi pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni.

17. Denoncim nr. *** prot., datë 16.4.2021, i shtetasit E.K, i cili denoncon shumë subjekte, ndër to edhe gjyqtaren Arbena Ahmeti, për vendime të padrejta ndaj tij. Vërehet nga studimi i praktikës së vënë në dispozicion nga denoncuesi se nuk ka *indicie* për hetime të mëtejshme ndaj subjektit të rivlerësimit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Arbena Ahmeti ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, dhe referuar gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arbena Ahmeti, gjyqtare në Gjykatën Administrative Tiranë.
 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 1.11.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi